



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 685, datë 14.11.2023**

**PËR**

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM  
GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Yllka Rupa,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR  
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE  
VEPRIMTARISË PROFESIONALE

---

**ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E  
VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR  
ÇDO KRITER VLERËSIMI**

---

**1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES**

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsyetimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.*

**1.A. NJOHURITË LIGJORE**

**1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE**

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë nuk është e lidhur as me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në vijim, analizohet mënyra se si janë evidentuar këta elementë ligjor në vendimet burim vlerësimi për gjyqtaren {...}.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).
- Vendimi i administruar për shkak të ankesave nga organet e rivlerësimit që i përket periudhës së vlerësimit, konkretisht çështja me nr. 52111-02454- 208/1472 Akti, date regjistrimi 17.12.2015 dhe përfunduar me vendimin nr. 11-2016-1603 -432 date 07.4.2016, dëmtuar akuzues M SH, i akuzuar Y M. Për veprën penale të parashikuar nga neni 90/1 i K. Penal dhe 84 i K. Penal.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Subjekti i rivlerësimit gjyqtare {...}, ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtarja {...}, kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile objekt shqyrtimi gjyqësor. Vendimi i dhënë prej saj në përfundim të gjykimit të çështjes civile është ankimuar nga palët, por është lënë në fuqi nga gjykatat më të larta (shih analizën e vendimit që i përket dokumentit nr.1). Gjyqtarja {...}, në të drejtën penale, kualifikon saktë veprën penale dhe është korrekte në zgjedhjen e llojit e masës së dënimit që duhet të caktohet ndaj të pandehurit të deklaruar fajtor, duke respektuar kriteret e parashikuara nga neni 47 i K. Penal (shiko analizën e vendimeve që ju përkasin dokumenteve 2 e 3 dhe dosjeve 2, 3 dhe 4). Ndërkohë në dosjen penale nr.1, gjyqtarja ka dhënë vendim pafajësie bazuar në nenin 388/d të K.Pr.Penale. Gjithashtu, gjyqtarja {...} respekton masën e dënimit që parashikon neni 51 i K. Penal, në rastin e të pandehurit të mitur të deklaruar fajtor, por mban në konsideratë edhe standartet ndërkombëtare të përcaktuara në një sërë dokumentash të rëndësishëm, si Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Rregullat Standart Minimum për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit, (Rregullat e Pekinit), Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të rinjve që ju është hequr liria (Rregullat e Havanës), etj. (shih më hollësisht analizën e vendimit të dosjes nr. 2). Gjyqtarja {...} njeh dhe zbaton alternativat e dënimit me burgim kur nuk shihet e domosdoshme, burgosja e të pandehurit të dënuar penalisht, veçanërisht e të pandehurit të mitur (shih analizën e vendimit të dokumentit nr. 3 dhe vendimet që ju përkasin dosjeve 2, 3, dhe 4). Në këtë rast, krahas legjislacionit vendas, gjyqtarja referon edhe në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë. (Për më shumë hollësi shih analizën e vendimit të dokumentit nr. 3 dhe vendimet që ju përkasin dosjeve 2, 3, dhe 4). Gjyqtarja {...}, kur është rasti i referohet në zgjidhjen e çështjes jurisprudencës së gjykatave më të larta të vendit përfshirë këtu Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë sidomos praktikatat unifikuese të kësaj të fundit, madje edhe jurisprudencës së GJEDNJ-së (shih vendimet që ju përkasin dosjeve (1-5 dhe dokumenteve 1-3). Në të drejtën procedurale penale, gjyqtarja respekton

të drejtën e të pandehurit për të patur avokat mbrojtës në gjykim, merr masa dhe garanton të drejtën e të miturit për të patur domosdoshmërisht avokat edhe kur ai nuk e ka zgjedhur vet një të tillë, madje siguron edhe prezencën e psikologut gjatë gjykimit të një të mituri (shih dosjen nr. 2), aplikon kur është rasti gjykimin e posaçëm, (gjykimin e shkurtuar), (shih dokumentet 2-3 dhe dosjet 1 4), si dhe ka njohuri të mira në caktimin e masave të sigurimit personal (shih dosjen 5) etj. Në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së një mase sigurimi të caktuar nga gjykata jokompetente, gjyqtarja {...} zbatoi me përpikmëri kërkesat e nenit 88, por edhe ato të nenit 228 të K.Pr.Penale. Në të drejtën civile e procedurale civile, gjyqtarja njeh dhe zbaton drejt dispozitat e Kodit Civil mbi përmbushjen e detyrimit që buron nga ligji apo kontrata, dispozitat lidhur me zgjidhjen e kontratave në rast mospërmbushje të detyrimeve kontraktore, njeh dhe zbaton saktë dispozitat e ligjit nr. 10031, dt. 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, etj “

***Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

***- Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:***

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja përshkuan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Fakti juridik civil apo penal vjen gjithmonë i integruar me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim

Në të gjitha vendimet e vëzhguara, pavarësisht natyrës së gjykimit (gjykim civil, gjykim penal) apo llojit të gjykimit të zhvilluar në çështjet penale (gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar), rrethanat e fakteve përshkruhen në pjesën e parë të pjesës përshkruese/arsyetuese të vendimit në pjesën e titulluar “ Rrethanat e çështjes”. Gjyqtarja, nxjerr faktet e provuara nga tërësia e provave të administruara në gjykim duke përshkruar fillimisht kronologjinë e ngjarjes gjatë së cilës ka ndodhur fakti penal, si dhe veprimet e kryera nga i pandehuri, duke i integruar provat mbi të cilat mbështeten faktet.

Si në kërkesat penale edhe në çështjet penale me objekt akuzat “Marredhenie seksuale ose homoseksuale me të mitur” “Vjedhja”, “Përvetësim i parave ose i mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”, “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armeve luftarake”, “Kundërshtimi i punonjësve të policisë së rendit publik” dhe “ Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” pa dëshmi aftësie etj, faktet e çështjes janë të evidentuar në mënyrë përshkruese në nënndarjen e parë me titull “Rrethanat e çështjes”, paraqiten në mënyrë kronologjike bashkë me veprimet hetimore dhe procedurale të kryera nga organi i prokurorisë dhe policisë gjyqësore. Në këtë mënyrë ato identifikohen lehtë dhe janë të pasqyruara në mënyrë të plotë dhe të qartë. Gjyqtarja paraqet të gjitha faktet e referuara dhe veprimet proceduralë të kryera me qëllim provueshmërinë e tyre.

Sa më sipër, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja përshkuan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Fakti juridik penal/apo civil vjen gjithmonë i integruar me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim.

***-Identifikimi i natyrës së çështjes***

Në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtarja përcakton sakte dhe qartë natyrën e marrëdhënies juridike të cenuar si dhe llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri në çështjet penale. Në rastin e gjykimit të çështjeve penale kërkesa e palëve për gjykim të shkurtuar në çdo rast citohet praktika Unifikues e vendosur me vendimin nr. 2, datë 29.01.2003 të Gjykatës së Lartë.

- ***Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm***

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtarja identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Nga burimet e vlerësimit konstatohet se:

(i) *Në vendimet penale*, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, ashtu edhe dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal.

- Konkretisht, gjyqtarja identifikon në funksion të cilësimit juridik të faktit penal nenin 283/a të K. Penal në lidhje me veprën penale “ Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me me te mitur”<sup>1</sup> nenin 100/1 i K Penal, “Vjedhje” nenin 134 i K Penal,<sup>2</sup> në lidhje me veprën penale “*Drejtimin të automjetit në mënyrë të parregullt*”, duke qenë se kjo është një dispozitë *blankete*, gjyqtarja referon nenin 115 pika 1 të ligjit nr.8378, datë 22.07.1998, “*Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar. Per veprat penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armeve luftarake, dhe e municionit”, “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armeve luftarake, dhe e municionit”, “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armeve te gjuetise dhe sportive”;<sup>3</sup> nenin 278/2 dhe 278/3, 280 të Kodit Penal, në lidhje me veprat penale të “ *Pervetësim i parave ose i mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale*”, nenin 287/b i Kodit Penal,<sup>4</sup> për veprën penale të “Kundërshtim i punonjesit te policise se rendit publik”, nenin 236/1 të Kodit Penal, Ligji Nr. 108/2014 “Per Policine e Shtetit” neni 101 i tij. <sup>5</sup>Për veprën penale të “ Prodhim dhe shitje të lendeve narkotike” gjyqtarja citon nenin 283/1 i Kodit Penal <sup>6</sup>. Identifikon dispoziten 199/a/1te Kodit Penal për veprën penale te “*Ndertimi paligjshem*”<sup>7</sup>; Per veprën penale te “Trafikim i mjeteve motorike” gjyqtarja identifikon nenin 141/a/1 i K. Penal <sup>8</sup>.
- Referohen dispozita të Kodit Penal, të pjesës së posaçme në lidhje me individualizimin e dënimit apo edhe aplikimin e alternative të dënimit (*nenet 47, 48, 49, nenet 59 të K. Penal*),

<sup>1</sup> Vendimi nr.1187 datë 10.12.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durres.

<sup>2</sup>Vendimet nr.797, datë 28.07.2016; nr.634 datë 07.06.2016 te Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durres.

<sup>3</sup>Vendimet nr.1300 datë 31.12.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durres.

<sup>4</sup> Vendimi nr. 860 datë 13.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durres.

<sup>5</sup> Vendimi nr. 778 datë 21.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durres.

<sup>6</sup> Vendimi nr. 673 datë 05.10.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durres.

<sup>7</sup> Vendimi nr. 592 datë 23.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durres.

<sup>8</sup> Vendimi nr. 387 datë 24.03.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durres.

si dhe në një rast tjetër referohet alternativa e dënimit me burgim për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe kryerjen e një punë në interes publik (*neni 63 i K. Penal*).<sup>9</sup>

- Nenin 17 /1 i Kushtetutes në lidhje me dënimin penal që duhet të jete i drejtë dhe në përpjestim me veprën penale,
- Në çdo rast, gjyqtarja referohen dispozita të Kodit Penal, të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh. kriteret dhe parimet në caktimin e llojit dhe masës së dënimit (neni 47 i K. Penal), rrethanat lehtësuese dhe rënduese (nenet 47, 48, 49 dhe 50 , 51 të K. Penal), apo bashkimi i denimeve (neni 55 paragrafi 4 i K. Penal) etj.
- Neni 84 i K. Penal, në lidhje me veprën penale te “Kanosjes”(vendimin nr. 11-2016-1603 - 432 date 07.4.2016),

Në lidhje me identifikimin e dispozitave procedurale penale, gjyqtarja referon, si pjesë e integruar e arsytimit të vendimit, dispozita të ligjit procedural penal:

- Nenet 228, 229, 230, 234, 260,263,264,266 te K.Pr.Penale (*caktim mase sigurimi*)<sup>10</sup>
- Nenet 356, 357, 379 e vijues, nenet 403 ,404 dhe 405 të K.Pr.Penale lidhur administrimin e provave shkresore dhe procedimin me gjykim të shkurtuar, nenin 406 të K.Pr.Penale, lidhur me mënyrën e caktimit të dënimit në rastet e procedimit me këtë lloj të posaçëm të gjykimit<sup>11</sup>;
- Nenet 190/6/c të K.Pr.Penale në lidhje me disponimin mbi provat materiale<sup>12</sup>
- Nenin 393/1 dhe 485 të K.Pr.Penale, lidhur me shpenzimet gjyqësore në procesin penal;

Në të gjitha vendimet objekt vleresimi Gjyqtarja krahas dispozitave të Kodit Penal, dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe një sërë dispozitash të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, si më poshtë:

- Vendimi nr. 19 date 01.06.2011 i Gjykatës Kushtetuese, neni 17/1,(*vendimi nr. 1219 date 16.12.2015*)
- Vendimi Unifikues nr. 4 date 15.04.2011 i Kolegjeve të Bshkuara te Gjykates se Lartë, ne lidhje me analizimine kater elementeve si kusht i kryerjes se veprës penale ne bashkpunim. (*vendimi nr. 1210 date 29.12.2015*)
- Vendimi nr.73 date 06.03.2013 I Kolegjit Penal te Gjykates se Lartë, ne lidhje me percaktimine anës subjektive. (*vendimi nr. 1210 date 29.12.2015*)
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 20 Nëntor 1989 dhe është ratifikuar nga republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 7531, date 11.12.1991,(*vendimi nr. 1219 date 16.12.2015*)
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi Nr. R (99) 22 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare në lidhje me mbipopullimin e burgjeve, paragrafi 1, paragrafi 14. ,(*vendimi nr. 1219 date 16.12.2015, vendimi nr. 1210 datë 29.12.2015*)

<sup>9</sup> Vendimi nr. 673/1, datë 16.03.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

<sup>10</sup> Vendimi nr. 1219, datë 16.12.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

<sup>11</sup> Në të gjitha vendimet, perjashto vendimin nr. 778 date 21.07.2016 i Gjykates së Rrethit Gjyqësore Durrës (gjykim i zakonshëm).

<sup>12</sup> Pjesa urdhëruese e Vendimit nr. 1300, datë 31.12.2015, vendimit nr. 860 datë 13.09.2016, vendimi nr.797 datë 28.07.2016 te Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

## KONKLUZIONI

Në tërësi, rezulton aftësia e gjyqtarës për paraqitjen dhe analizës e plotë të fakteve, si atyre me natyrë procedurale, në të cilat jep një panoramë të qarte të ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizen ligjore në rastet kur elementet procedurale lidhen në trajtimin e kërkesave të palëve apo elementë procedurale të vlerësuar kryesisht nga gjykata, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes të cilat përgjithësisht paraqiten në mënyrë të përmbledhur, duke integruar në shumicën e rasteve dhe provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Po ashtu rezulton se gjyqtarja {...} ka aftësi të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin e "Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin normave" vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 25 pikë.*

### 1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t'i japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: 1).... *Subjekti i rivlerësimit gjyqtare {...}, ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit.."*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (asaj materiale - civile apo penale, si dhe procedurale penale në rastin e kërkesave penale) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Në çdo vendim

burimvlerësimi normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes dhe në asnjë rast citimi i dispozitave nuk është i pashoqëruar me ndërthurjen e interpretimit të tyre mbi faktin konkret, ose konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen.

- ***Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm***

*(i) Në vendimin civil:* Përgjithësisht interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin abstrakt të saj duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Konkretisht, në mënyrë më specifike në të vetmin vendimin civil nr.7209 datë 23.06.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, burim vlerësimi evidentohet se gjyqtarja:

- a) Interpreton dispozita të K.Civil në fuqi konkretisht neni, 67 (*bëhet fjale për rastet e kur perfaqesuesi kryen veprimet për veten e tij*), neni 78 (*kur perfaqesuesi ka kapercyer tagrat që i janë dhënë ...*), neni 80 (*veprimi juridik mund të kryhet me çfaredo lloj shfaqje të padyshimite të vullnetit*), neni 422 (*Kreditori dhe debitori duhet të sillen me njeri tjetrin me korrektesë dhe paanësi sipas kërkesave të arsyes*), neni 463, 663 (*në lidhje me plotësimin e katër elementeve të parashikuara nga ky nen në momentin e nënshkrimit të kontratës*) neni 702 (*në lidhje me të drejtën e paleve për të zgjidhur kontratën*) në të njëjtën kohë duke i dhënë përgjigje dhe pretendimeve të paleve në këto mënyrë . Gjithashtu gjyqtarja merr në analizë Ligjin nr. 10031, dt.11.12.2008 “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”, Udhëzimi i MD-MF, nr.1240/5, dt. 15.09.2009 “Për caktimin e tarifave përmbarrimore për shërbimet e ofruara nga shërbimi gjyqësor privat” si dhe dispozitat të kontratës së shërbimit përmbarrimor objekt gjykimi.

*Në vendimet penale:* Në vendimet penale të analizuara, duke iu referuar natyrës së çështjes, e cila përcakton edhe elementët që duhet të analizohen në aspektin e provueshmërisë së fakti penal, gjyqtarja interpreton normën përkatëse të Kodit Penal në mënyrë abstrakte, duke dhënë kuptimin e saj dhe duke evidentuar dhe analizuar elementët e figurës së veprës penale konkrete, veçanërisht në çështjet penale të themelit, ku ky interpretim është i domosdoshëm (*nenet 134/1, 287/b, 291, 100/1, 278/2, 278/3, 280 të K.Penal*). Interpreton dispozitat materiale në funksion të përcaktimit të cilësimit juridik të veprës penale dhe përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj. Kryesisht, konstatohet se gjyqtarja interpreton teorikisht normën relevante të Kodit Penal, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale përkatëse që i atribuohet të pandehurit, dhe në vijim duke e përputhur me faktet dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, nxjerr konkluzionin në lidhje me përgjegjësinë penale të autorit. Dispozitat e Kodit Penal (*të pjesës së posaçme*) analizohen në mënyrë të detajuar në të katër elementët e figurës së veprës penale, duke u përqendruar më tepër në anën objektive të saj. Kjo analizë kryhet në të gjitha vendimet penale burim vlerësimi. Gjyqtarja identifikon dhe interpreton ligjet e posaçme, në ato raste kur dispozita penale materiale ku të referon fakti penal është një dispozitë *blanket*, si p.sh: Në Vendimin nr. 1210 datë 29.12.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Gjyqtarja duke pasur në konsideratë se neni 291 i K.Penal, është dispozitë *blankete*, është referuar në Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 «Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë» mbi



detyrimin për t'u pajisur me leje drejtimi për automjete dhe motomjete nga dega e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Përpos interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin e veprave penale përkatëse për të cilat akuzohen të pandehurit, evidentohet edhe interpretimi i dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, në lidhje me individualizimin e dënimit (*nenet 47, 48, 49, 50 të K.Penal*) ose aplikimin apo jo të alternativave të dënimit (*neni 59 dhe 63 të K.Penal*). Në këto raste, gjyqtarja ndalet në qëllimin, funksionin dhe kushtet që duhet të përmbushen për të përfituar i pandehuri nga një masë dënimi më e ulët apo edhe të një dënimi alternativ të parashikuar në nenin 63 të K.Penal.<sup>13</sup> Në të gjitha vendimet penale, Gjyqtarja ka analizuar në mënyrë të detajuar sa i përket llojit dhe masës së dënimit: kriteret e rrezikshmërisë së veprës penale (objekti, vendi, koha, mënyra, pasoja, rrethanat që kanë ndikuar); kriteret e rrezikshmërisë së autorit të veprës penale (qëndrimi i autorit ndaj veprës penale dhe pasojave; gjendja sociale, arsimimi, gjendja në të cilën kryhet, gjendja gjyqësore); kriterin e shkallës së fajësisë; kriteret e rrethanave lehtësuese; kriteret e rrethanave rënduese. Gjyqtarja referon në çështjen *Vinter dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* për të arsyetuar një nga funksionet e dënimit penal, atë të parandalimit të të pandehurit për të kryer sërish vepra penale (*vendimi nr. 1300 datë 31.12.2015 i Gjyqates se Rrethit Gjyqësore Durrës*).

***Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale*** civile dhe penale, gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normës, jo vetëm sa i përket aspekteve të themelit të çështjes, por edhe atyre procedurale, në rastet kur ngrihen çështje të procedurës, apo kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel. Konkretisht:

- a) Në vendimin nr. 7209 datë 23.06.2014 të Gjyqates se Rrethit Gjyqësore Tirane , gjyqtarja ben intepretim te nenit 159 të K.Pr.C (*vecimi i shqyrtimit të kerkimeve*) si dhe të neni 185 i K.Pr.C (*shtimi dhe saktësimi i objektit te padisë*).
- b) Në vendimin penal me objekt akuzat “Kundershtim i punonjësi të policisë së rendit publik “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” pa dëshmi aftësie”, Gjyqtarja ka bërë një interpretim literal dhe sistematik të neneve 128 germa “c”, 142, 247, 308 të K.Pr.Penale, i ka dhënë përgjigje pretendimeve të mbrojtjes për pavlefshmerine absolute të kerkeses per gjykim sidhe akteve te procedimit penal.
- c) Në çështjet penale të themelit gjyqtarja interpreton dispozitat procedurale në mbështetje të argumentimit të saj në lidhje me vlerësimin lidhur me kërkesën për procedim me gjykim të shkurtuar (*nenet 128, 403, 404 i K.Pr.Penale*), në mbështetje të të cilit referon edhe praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë (*vendimin nr. 2, datë 29.01.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*);

- ***Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante.***

Në disa nga vendimet e analizuara rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës*

---

<sup>13</sup>Vendimi nr.1219, datë 16.12.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, vendimi nr.1210 date 29.12.2016 i Gjyqates se Rrethit Gjyqësore Durrës.

*Kushtetuese, vendimet e GJEDNJ, në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:*

- a) Në vendimin nr.860 datë 13.09.2016 të Gjyqates së Rrethit Gjyqësorë Durrës, Gjyqtarja e ka mbështetur analizën e saj juridike duke iu referuar jurisprudences së Gjyqates së Lartë konkretisht vendimeve nr. 315 date 22.11.2014 dhe vendimi nr. 73 datë 06.03.2013 i Kolegjit Penal të Gjyqates së Lartë, në lidhje me verifikimin e bashkeekzistences se elementeve të vepres penale te cilat i ka integruar në pjesën arsyetuese të vendimit gjyqësor. Ne po kete vendim referohet nenit 8/11 i KEDNJ-së dhe nenit 37 të Kushtetutes se RSh. në lidhje me të drejten e respektimit të jetës private, familjare baneses .
- b) Në vendimin nr. 1300, datë 31.12.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durres, Gjyqtarja inkorporon në vendim jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (çështjet *Vinter etj kundër Mbretërisë së Bashkuar*). Në funksion të arsyetimit për aplikimin e nenit 59 të K.Penal citohet jurisprudenca e Gjyqates se Larte, vendimi nr. 228 datë 19.04.2006 të Gjyqates së Lartë.
- c) Në vendimet penale, kur është proceduar me gjykim të shkurtuar, rezulton se nga ana e Gjyqtares është cituar dhe zbatuar në drejtim të vlerësimit për pranimin e kërkesës për të proceduar më gjykim të shkurtuar, vendimi unifikues nr. 2, datë 29.01.2003, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- d) Në vendimin nr.797, datë 28.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durres, Gjyqtarja, në funksion të arsyetimit në lidhje me rrezikshmerinë e vepres penale ka referuar në nenin 41 të Kushtetutës.
- e) Në vendimin nr. 1187 datë 10.012.2015, Gjyqtarja në analizën ligjore të vepres penale të parashikuar nga neni 100/1 i Kodit Penal, i referohet gjithashtu dhe Kodit Penal të Kosovës (Ligji Nr. 04L/082),për një analizë më të detajuar duke cituar dhe permbajtjen e dispozites specifike. Në caktimin dhe llojin e masës së denimit gjyqtarja në vijim të analizes e kriterëve te caktimit të denimit referon edhe në Konventën “Për të Drejtat e Femijëve” konkretisht nenin 19 të saj, duke rritur akoma më shumë rendësinë mbrojtjes se lirise seksuale te femijeve dhe rrezikshmerisë së vepres penale të sipercituar.
- f) Ne vendimin nr. 1296 datë 30.12.2015 Gjyqtarja në analizën ligjore të vepres penale te parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal, i referohet GJEDNJ, konkretisht *çeshtjes Bevacqua and S.v.Bulgaria nr. 71127/01 datë 12.09.2008; çështjes “Valiulienev.Lithuania” Nr. 33234/07 datë 26.06.2006 paragrafi 67;Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Kehsillit te Evropës datë 18 Nëntor 2009 “Mbi integrimin e startegjive kombëtare për mbrojtjen e femijëve nga dhuna”.*

***-Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës***

Nga tërësia e vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtarja në disa raste, gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet në të gjitha vendimet objekt velresimi por jo duke i përmendur ato shprehimisht, por duke iu referuar kontekstit të arsyetimit dhe analizës ligjore të vendimit. Nga tërësia e vendimeve rezulton se gjyqtarja njeh dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- a) *Parimin e ligjshmërisë (mosdënimi pa ligj)* – Nuk citohet shprehimisht por ky parim

është nxjerrë nga konteksti i arsyetimit dhe konkluzionit të arritur në të gjitha vendimet penale të themelit në të cilat gjyqtarja analizon domosdoshmërinë e ekzistencës dhe provueshmërisë së të katër elementëve të figurës së veprës penale, si kusht për ekzistencën e saj dhe për pasojë, për përgjegjësinë penale të të pandehurit për faktin penal që i atribuohet.

- b) Parimet e përgjithshme në caktimin dhe individualizimin e dënimit, *si parimi i barazisë para ligjit, parimi i drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe parimi i humanizmit*. Këto parime rezultojnë të jenë zbatuar nga gjyqtarja në të gjitha vendimet penale të themelit, ku ajo interpreton paraprakisht qëllimin e dënimit penal dhe më pas vijon me përcaktimin dhe individualizimin e dënimit, duke iu referuar kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 47 të Kodit Penal, prezencën dhe ndikimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese.
- c) *Parimin e procesit të rregullt ligjor*, aspekte të të cilit rezultojnë nga konteksti i vendimeve të analizuara, në të cilat rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi elementëve të tillë si: disponibiliteti i padisë nga ana e paditësit, mosdalja tej kërkimeve të padisë (*neni 6 i K.Pr.Civile*), barra e provës, kontradiktoriteti, garantimit të një hetimi të plotë e të gjithanshëm, etj.

## KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën e Gjykatës Kushtetuese, praktikën e konsoliduar të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Shumë lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

## 1.B. ARSYETIMI LIGJOR

### 1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 vendim i administruar për shkak e ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *Subjekti i rivlerësimit {...}, ka shfaqur aftësi shumë të mira duke i kushtuar mjaft vëmëndje arsytimit ligjor të vendimeve të dhëna prej saj. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të qarta, të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar, provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Jo vetëm citohet përmbajtja e provave, por ato analizohen dhe krahasohen me njëra-tjetrën në funksion të vërtetësisë së fakteve që ato përmbajnë.*

*Rëndësi në analizë, vlerësim, çmim të provave i kushtohet, si atyre të fakteve të cilat konsiderohen të bazuara ashtu edhe atyre fakteve, të cilat gjyqtarja i cilëson si të pambështetura në prova. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse, i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjyqimit, si atyre që vlerësohen si të bazuara ligjërisht, ashtu edhe atyre që rrëzohen si të pambështetura në ligj, duke treguar se gjyqtarja ka qënë e vëmëndshme ndaj kërkesave të tyre. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsytimit të vendimit gjyqësor. Struktura e vendimit është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, si legjislacionit të brendshëm, ashtu edhe atij ndërkombëtar (Konventave të ratifikuara nga vendi ynë). Niveli i arsytimit të vendimeve të vëzhguara respekton plotësisht standartin e procesit të rregullt ligjor. Vendimet e ndërmjetme shoqërohen gjithnjë me referencë ligjore dhe kur duhet jepen arsye për dhënien e tyre (shih 5 dosjet e vëzhguara).*

#### ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Në arsytimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të faktit, rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Rezulton, si rregull në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (*ë dhe ç*). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsytimit të vendimit, gjithashtu.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, evidentohet në ndonjë rast përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine.

Në arsytimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra-tjetrës dhe paragrafët e arsytimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në

lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit në të cilin përdoren. Vendimi është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

## **1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRË ORGANIZUAR E VENDIMIT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 vendim i administruar per shkak e ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të qarta, të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar, provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Jo vetëm citohet përmbajtja e provave, por ato analizohen dhe krahasohen me njëra-tjetrën në funksion të vërtetësisë së fakteve që ato përmbajnë. Rëndësi në analizë, vlerësim, çmim të provave i kushtohet, si atyre të fakteve të cilat konsiderohen të bazuara ashtu edhe atyre fakteve, të cilat gjyqtarja i cilëson si të pambështetura në prova. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse, i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimit, si atyre që vlerësohen si të bazuara ligjorisht, ashtu edhe atyre që rrëzohen si të pambështetura në ligj, duke treguar se gjyqtarja ka qënë e vëmëndshme ndaj kërkesave të tyre. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura e vendimit është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar.”

Organizimi i arsyetimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do

të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin, apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi, në funksion të orientimit të lexuesit dhe të kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit, një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtarja i tregon kujdes për prezantimin e fakteve, identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Evidentohet ndjekja e një metodologjie të qartë në strukturimin e pjesëve përbërëse të vendimit. Vendimet gjyqësore penale/civile burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit. Konstatohet se vendimi civil nr.7209 datë 2306.2014 ( *i vetmi vendim civil burim vlerësimi*) përmban të gjithë elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile:

*Në pjesën hyrëse* gjejnë pasqyrim të dhënave lidhur me gjykatën, koha dhe vendi i zhvillimit të gjykimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre, objekti dhe baza ligjore e padisë, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, në mënyrë të përmbledhur.

*Në pjesën përshkruese-arsyetuese* gjejnë pasqyrim në mënyrë të strukturuar: (i) *Rrethanat e çështjes*, në të cilën gjyqtarja rendit në mënyrë kronologjike të gjithë mosmarrveshjen objekt shqyrtimi; (ii) *Aspektet Procedurale*, në këtë pjesë gjykata i jep përgjigje kërkesave procedurale të palëve si , kërkesa për vecimin e shqyrtimit të kërkesave, kërkesës për aktësimi i objektit e padisë, thirrjen e Avokatures së Shtetit, kërkesa për caktim ekspertit konform nenit 224/a ; (iii) *Pretendimet e Palëve* duke filluar me pretendimet e palës paditëse në lidhje me masën e sigurimit të padisë , themelin e çështjes, parashtrimi në mënyrë të përmbledhur i pretendimeve të palëve; (iv) *Ligji i Zbatueshëm*, pjesë në të cilën citohen të gjitha dispozitat materiale, për të vijuar më tej me (vi) *Vlerësimin e Gjykatës*, ku gjykata merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarës dhe konkluzionet e saj.

*Pjesa e dispozitivit* është e qartë, koncize, e thjeshtë dhe e kuptueshme, duke bërë të qarta disponimet e gjykatës lidhur me objektin e padisë, si dhe elementët e tjerë të vendimit lidhur me shpenzimet gjyqësore, të drejtën e ankimit, etj. Konstatohet se vendimi gjyqësor përmban të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, në nenin 310 të K.Pr.Civile.

Në vendimet penale po kështu, konstatohet se përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale:

*Pjesa hyrëse* përmban të gjithë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues, kohën e zhvillimit të gjykimit, të dhënave e plotë të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, akuzën e plotë, nenin përkatës të Kodit Penal, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, në mënyrë të përmbledhur.

Pjesa përshkruese-arsyetuese e vendimit është e organizuar në tre pjesë kryesore, të cilat janë të ndara në paragrafë, të cilët ndjekin rrjedhë dhe lidhje logjike midis tyre. Në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese pas pjesës Vëren, vijon me *“Rrethanat e faktit”* pasqyron rrethanat e faktit në mënyrë kronologjike sipas akteve të ndodhura në dosje pjesë e fashikullit hetimor, gjyqtarja ka renditur kërkesat procedurale që kanë rezultuar gjatë shqyrtimit të çështjes në themel, si pranimi i kërkesës për zhvillimin e gjykimit sipas ritit të gjykimit të shkurtuar (citon vendimin Unifikues nr. 2 viti 2013 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë). Gjithashtu, Gjyqtarja vijon me pjesën e dytë *“Ligji i Zbatueshem”* duke i kushtuar rendesi përcaktimit të saktë të veprës penale, citohet neni të cilit i referohet vepra penale dhe përmbajtja e tij dhe vijon me *“Analiza Ligjore”* e cila fillon me citimin e Kreut III të K.Penal, ku legjislatori ka parashikuar veprën penale për të cilën akuzohet i pandehuri, me pas Gjyqtarja bën një interpretim teorik të rëndësisë së përcaktimit të saktë të veprës penale, parimit të ligjshmërisë dhe elementëve që duhet të plotësojë në unitet figura e veprës penale. Gjyqtarja bazuar në vlerësimin në tërësi të akteve dhe provave të fashikullit cmon se nga i pandehuri janë konsumuar plotësisht elementet e veprës penale. Gjyqtarja referon faktet e rezultuara nga provat e shqyrtuara e administruara duke bërë një analizë të sëcilës dhe duke referuar dhe në dispozitat ligjore njëkohësisht. Pjesa e tretë e vendimit vijon me *“Caktimi i llojit dhe i masës së dënimit”*. Në lidhje me llojin dhe masën e dënimit gjykata ka marrë në analizë kriteret e caktimit të dënimit mbështetur nën 47 i K.Penal, si: *Rrezikshmërinë e veprës penale, kohën dhe kryerjen e kesaj vepre penale, pasojat e veprës penale rrethanat që kanë ndikuar, rrezikshmërinë e autorit, shkallën e fajësive, rrethanat lehtësuese dhe rrethanave të rëndësive të parashikuara nga neni 50 i K.Penal*, pra gjyqtarja ka bërë një analizë të detajuar të të gjithë elementeve që ndikojnë në llojin dhe masën e dënimit. Në pjesën e fundit të pjesës së tretë të vendimit gjyqtarja ka disponuar edhe në lidhje me provat materiale bazuar në nën 190/1, germa “b”, “c” dhe nën 393/1 dhe 485 i K.Pr.P për shpenzimet gjyqësore.

Dispozitivi i vendimeve gjithmone është i plotë, i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, duke përmbajtur në mënyrë të qartë të gjitha disponimet e gjykatës lidhur me *fajësinë e të pandehurit, akuzën përkatëse, nën respektiv të Kodit Penal, llojin dhe masën e dënimit, uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar, disponimin e plotë për shpenzimet procedurale, si dhe të drejtën e ankimit*. Pjesa urdhëruese e vendimit është e qartë, koncize, e plotë, e lexueshme dhe e kuptueshme, duke bërë të qarta disponimet e gjykatës lidhur me të gjithë elementët e disponimit në vendimin përfundimtar, në funksion të qartësisë së tij për palët dhe lexuesin, si dhe të ekzekutimit të tij.

Pavarësisht titullimit të aspekteve të arsyetuara në vendime, nga përmbajtja e vendimit rezulton se Gjyqtarja në mënyrë të detajuar analizon: (i) Rrethanat procedurale, në të cilën gjyqtarja përshkruan në mënyrë kronologjike ecurinë procedurale çështjes, duke filluar me paraqitjen e çështjes në gjykatë, si dhe disponimin e gjykatës lidhur me kërkesën paraprake të të pandehurit për procedim me gjykim të shkurtuar apo kërkesat e tjera për pretendimet mbi provat siç janë papërdorshmëria e provave. (ii) Rrethanat e fakteve të çështjes, gjyqtarja përshkruan faktin penal objekt akuze, në përputhje dhe të integruar me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. (iii) Në përgjithësi pasqyron edhe pretendimet e palëve gjatë gjykimit, pas parashtrimit të rrethanave të çështjes; (iv) Vlerësimi dhe analiza juridike, në të cilën gjyqtarja merr në analizë ligjin e

zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtares dhe konkluzionin e saj.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, e cila është e dukshme në aspektin vizual dhe të përmbajtjes, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecures logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tij.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

### **1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK**

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 vendim i administruar për shkak e ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se... “Subjekti i rivlerësimit {...}, ka shfaqur aftësi shumë të mira duke i kushtuar mjaft vëmendje arsyetimit ligjor të vendimeve të dhëna prej saj. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse, i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimit, si atyre që vlerësohen si të bazuara ligjërisht, ashtu edhe atyre që rrëzohen si të pambështetura në ligj, duke treguar se gjyqtarja ka qënë e vëmëndshme ndaj kërkesave të tyre...”

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***



Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuara rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material, civil apo penal.

Evidentohet kujdesi i gjyqtarës në arsyetim, për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar edhe analizën e koncepteve ligjore, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse.

Evidentohet fakti që në arsyetimin e vendimeve penale (*meqenese kemi burim vleresimi vendime penale kryesisht*), në analizën e përdorur, gjyqtarja i kushton një rëndësi të veçantë lidhjes shkakësore të faktit penal, duke qenë se rëndësia e lidhjes shkakësore qëndron në kuptimin ndërmjet shkakut dhe pasojës së ardhur nga kryerja e veprës penale.

#### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe u jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse, si në çështjet penale ashtu edhe në çështjet civile.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

#### **Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarës”**

Nivelin e vlerësimit AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

## 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës Olkeda LICE në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e tij, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.*

### 2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

#### 2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe nje vendimi te administruar per shkak te ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: Në 5 dosje të vëzhguara, është konstatuar se në të gjitha rastet, është respektuar afati ligjor ose afati standart i gjykimit (shih dosjet 1,2, 3, 4 dhe 5), duke dëshmuar se gjyqtarja {...}, i kushton rëndësinë e duhur respektimit të afatit kohor të arsyeshëm në gjykimin e çështjeve si pjesë e procesit të rregullt ligjor...”

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar çështjeve të përzgjedhura me short, vendimeve të zgjedhura nga gjyqtarja, vendimit të administruar me indicie nga KPK.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, nje vendimi të administruar për shkak të ankesave, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për 1 (një) prej tyre parashikohet afat ligjor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes, konkretisht: Çështja e kategorisë kërkesë

penale (*caktim mase sigurimi nga gjykata jokompetente*), parashikohet si afat ligjor për përfundimin e gjykimit afati 10 diteve nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykatë,<sup>14</sup>

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër në të cilat për 1 (një) prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre dhe se në asnjë prej tyre nuk rezulton që gjyqtarja të ketë shkelur afatin ligjor për përfundimin e saj, e shprehur në përqindje 0-10% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Referuar metodologjisë së pikëzimit, përqindja matematikore prej 0-10% përkon me nivelin e vlerësimit maksimal 15 (pesëmbëdhjetë) pikë.

## **KONKLuzioni**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjet e analizuara për të cilat ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, duke pasur parasysh edhe shkaqet që kanë ndikuar në këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet në nivelin “0-10%”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

## **2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).
- Vendimi i administruar për shkak të ankesave nga organet e rivlerësimit që i përket periudhës së vlerësimit, konkretisht çështja me nr. 52111-02454- 208/1472 Akti, date rregjistrimi 17.12.2015 dhe perfunduar me vendimin nr. 11-2016-1603 -432 date 07.4.2016, idemtuar akuzues M SH, i akuzuar Y M. Për veprën penale të parashikuar nga neni 90/1 i K.Penal dhe 84 i K.Penal.

---

<sup>14</sup> Neni 88 i K.Pr.Penale parashikon se “...Masat e sigurimit të vendosura nga gjykata jokompetente 1. Masat e sigurimit të vendosura nga gjykata, e cila në të njëjtën kohë ose më vonë shpallet jokompetente për çdo lloj shkak, i humbasin efektet, në qoftë se brenda dhjetë ditëve nga marrja e akteve, gjykata kompetente nuk vendos për masën e sigurimit.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “ ..Në 5 dosje të vëzhguara, është konstatuar se në të gjitha rastet, është respektuar afati ligjor ose afati standart i gjykimit (shih dosjet 1,2, 3, 4 dhe 5), duke dëshmuar se gjyqtarja {...}, i kushton rëndësinë e duhur respektimit të afatit kohor të arsyeshëm në gjykimin e çështjeve si pjesë e procesit të rregullt ligjor. Gjithashtu, afati standart i gjykimit është respektuar edhe në dy nga tre dokumentet e përzgjedhura nga vet subjekti i rivlerësimit {...}. Kështu, në dokumentin nr.2, gjykimi ka përfunduar për një muaj e 3 ditë (gjykim penal “Dhuna në familje”); në dokumentin nr. 3, gjykimi ka zgjatur një muaj e 13 ditë (gjykim penal “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”. Në të dy rastet është respektuar afati standart 9 mujor i gjykimit i paracaktuar nga Sistemi i Vlerësimit. Ndërsa në dokumentin nr. 1, nuk është shënuar në vendim data e regjistrimit të çështjes, për rrjedhojë nuk nxjerrim dot përfundim për kohëzgjatjen e gjykimit të saj.....”.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 10<sup>15</sup> çështjeve të përzgjedhura me short, 3 vendimeve të zgjedhura nga gjyqtarja dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave nga organet e rivlerësimit që i përket periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, evidentohet se në çështjet e vëzhguara, gjykimi në përgjithësi ka përfunduar brenda standardeve minimale kohore, ku referuar Vendimit nr.261/2 të KLD, duke i ndarë sipas kategorisë së çështjeve, rezultojnë:

Vendimet burim vlerësimi rezultojnë si me poshte:

**Dosja 1.** Çështja penale nr. (71118-02490)1491/211 regjistri themeltar, datë 21.12.2015 regjistrimi, në ngarkim të të pandehurit: Genciana Shehaj, e akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Ndërtimit të paligjshëm”, e parashikuar nga neni 199/a/1 i K.Penal, e përfunduar me vendimin nr. 592, datë 23.05.2016.

Gjykimi i çështjes ka zgjatur 5 muaj e 2 ditë, në intervalin kohor 21.12.2015-23.05.2016, duke respektuar afatin standard 9 mujor të përcaktuar nga neni 5, gërma “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

**Dosja 2.** Çështja penale nr. (50397-00807)611 regjistri themeltar, datë 06.05.2016 regjistrimi, në ngarkim të të pandehurit Kleo Libohova, i akuzuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës

---

<sup>15</sup> Nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykim, konkretisht Çështja penale nr. (61005-01701) 673 regjistrimi, datë 30.09.2016 regjistrimi, që i përket: Kërkuetit: Prokuroria e Rrethit Durrës, me objekt: “Konfirmimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, caktuar me vendimin Nr. 2323, datë 17.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ndaj shtetasit S.K , i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, e parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal. Kjo çështje u përfundua me vendimin përfundimtar nr. 673(4305), dt. 05.10.2016.

Gjykimi i çështjes ka zgjatur 5 ditë, duke respektuar afatin 10 ditor të parashikuar nga neni 88 i K.Pr.Penale. Rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor për personat e arrestuar të përcaktuar nga neni 28 pika 2 të Kushtetutës dhe neni 5 pika 3 i KEDNj-së.

Vendimi nr.887, datë 25.08.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

*për kryerjen e veprës penale të: “Drejtim i mjeteve në mënyrë të parregullt”, vepër e parashikuar nga neni 291 i K.Penal. Kjo çështje ka përfunduar me vendimin nr. 634(2622), datë 07.06.2016.*

Gjykimi i çështjes ka zgjatur 1 muaj e 1 ditë, duke respektuar afatin 9 mujor të parashikuar nga pika 5 shkronja “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

**Dosja 3.** *Çështja penale nr. (71114-01930)1183 regjistri themeltar, datë 14.10.2015 regjistrimi, në ngarkim të të pandehurit Sandër Shkurta, i akuzuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës për kryerjen e veprës penale të “Dhuna në familje”, e parashikuar nga neni 130/a/1 i K.Penal. Kjo çështje ka përfunduar me vendimin nr. 1144, datë 26.11.2015.*

Gjykimi i çështjes ka zgjatur gjithsej 1 muaj e 12 ditë, në intervalin kohor 14.10.2015–26.11.2015. Kohëzgjatja e gjykimit është në respektim të afatit standard 9 mujor të përcaktuar nga pika 5 shkronja “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor, i parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

**Dosja nr. 4.** *Çështja penale nr. (53110-02089)1269 regjistri themeltar, datë 29.10.2015 regjistrimi, në ngarkim të të pandehurit Leonard Valbona, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Trafikim i mjeteve motorike”, e parashikuar nga neni 141/a/1 i K.Penal, e përfunduar me vendimin nr. 387(1394), datë 24.03.2016.*

Gjykimi i çështjes ka zgjatur, 4 muaj e 24 ditë, në intervalin kohor 29.10.2015-24.03.2016. Kohëzgjatja e gjykimit është në respektim të afatit standard 9 mujor të përcaktuar nga pika 5 shkronja “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor i parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Dosjet e perzgjedhur amë short paas fillimit te procedurës se vlerësimit:

**Dosja 6 (1) -** *Çështja penale me nr. regjistri 50140-01938/1188 datë regjistrimi 15.10.2015 me kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe të pandehur R. K, akuzuar për kryerjen e figurës së veprës penale të “Marredhenie seksuale ose homoseksuale me te mitur”parashikuar nga nenet 101 i Kodit Penal. Çështja ka përfunduar me vendimin nr. 11-2015-6040 (1187), datë 10.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjykimi ka zgjatur 56 ditë, ose rreth 1 muaj e 16 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale konform vendimit 261/2 të KLD.*

**Dosja 7 (2) -** *Çështja penale me nr. regjistri (50397-02298)1389 datë regjistrimi 24.11.2015 me kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe të pandehur A.Gj, akuzuar për kryerjen e figurës së veprës penale të “Drejtim i automjetit në menyrë të parregullt”parashikuar nga nenet 291 i Kodit Penal. Çështja ka përfunduar me vendimin nr. (11-2015-6188) 1219, datë 16.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjykimi ka zgjatur 21 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale konform vendimit 261/2 të KLD.*

**Dosja 8 (3) -** *Çështja penale me nr. regjistri (58318-02199) 1339 datë regjistrimi 12.11.2015 me kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe të pandehur A.S, akuzuar për*

*kryerjen e veprave penale të “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armeve luftarake dhe e municionit” parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armeve luftarake dhe e municionit” parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal, Prodhim dhe mbajtje pa leje e armeve te gjuetise” parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal. Çështja ka përfunduar me vendimin nr. (11-2015-6416) 1300, datë 31.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjykimi ka zgjatur 50 ditë, ose rreth 1 muaj e 19 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale konform vendimit 261/2 të KLD.*

**Dosja 9 (4) -** Çështja penale me nr. regjistri (53101-01278) 823 datë regjistrimi 12.07.2016 me kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe të pandehur Xh.P, akuzuar për kryerjen e figurës së veprës penale të “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal. Çështja ka përfunduar me vendimin nr. (11-2016-3489)797, datë 28.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjykimi ka zgjatur 16 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale konform vendimit 261/2 të KLD.

**Dosja 10 (5) -** Çështja penale me nr. regjistri (53101-01171) 860 datë regjistrimi 27.06.2016 me kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe të pandehur A.Ç akuzuar për kryerjen e figurës së veprës penale të “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal dhe G.Sh, akuzuar për kryerjen e figurës së veprës penale të “Pervetësimi i parave ose mallrave qe rrjedhin nga vepra penale ose veprimatrima kriminale” parashikuar nga nenet 287/b i Kodit Penal. Çështja ka përfunduar me vendimin nr. (11-2016-3880) 860 datë 13.09.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjykimi ka zgjatur 47 ditë, ose rreth 1 muaj e 17 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale konform vendimit 261/2 të KLD (duke iu hequr periudhën e lejes vjetore, muaji gusht).

**Dosja 11 (6) –** Kërkesa penale me nr. regjistri (58102-01204) 791 datë regjistrimi 30.06.2016 me kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me objekt caktimin emases mjeksore nga shtetasit F.H, marre nën hetim për veprën penale të “Kundershtim i punonjesit te policise se rendit publik” parashikuar nga nen i236/1 i Kodit Penal. Çështja ka përfunduar me vendimin nr. (11-2016-3405) 778 datë 21.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjykimi ka zgjatur 21 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale konform vendimit 261/2 të KLD.

Vendimet e perzgjedhura nga Gjyqtarja:

**Dokumenti 1.** Vendimi gjyqësor civil nr. 7209, datë 23.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, çështja civile me nr. regj. them. 7757, që i përket paditësit: Shoqëria “Tris Company” sh.p.k, kundër të paditurit Shoqëria “Cez Shpërndarje”, me objekt: “Zgjidhje e 112 kontratave të shërbimit përmbartimor nr. 331 datë 09.07.2012- Nr. 448, datë 11.07.2012. Detyrimin e palës së paditur të paguaj shumën 1.894.959 lekë si shpërblim i dëmit të shkaktuar. Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke vendosur bllokimin e të gjitha llogarive bankare të shoqërisë “Cez Shpërndarje” sh.a, deri në masën e detyrimit monetar. (Nuk perlllogaritet dot afati pasi nga vendimi nuk kemi te dhenat si data e rregjistrimit pervecse datën e perfundimit te cështjes).

**Dokumenti 2.** Çështja penale nr. (71114-02323)1401 regj. Them., datë 27.11.2015 regjistrimi, në ngarkim të të pandehurit Klodjan Hysenaj, i akuzuar nga Prokuroria e Rrethit Durrës, për

kryerjen e veprës penale të “Dhuna në familje”, e parashikuar nga neni 130/a/4 i K.Penal, çështje e përfunduar me vendimin nr. (11-2015-6426)1296, datë 30.12.2015. Gjykimi ka zgjatur 33 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale konform vendimit 261/2 të KLD.

**Dokumenti 3.** Çështja penale nr. (58102-02222)220/1348 regj. Them., datë 16.11.2015 regjistrimi, në ngarkim të të pandehurit Përparim Turra, i akuzuar nga Prokuroria e Rrethit Durrës, për kryerjen e veprës penale të “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, e parashikuar nga neni 236/2 i K.Penal, çështje e përfunduar me vendimin nr. (11-2016-6108)1210, datë 29.12.2016. Subjekti i rivlerësimit {...}, ka gjykuar si gjyqtar i vetëm. Gjykimi ka zgjatur 43 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale konform vendimit 261/2 të KLD.

Në lidhje me vendimin e administruar për shkak të ankesave pranë KPK, sa i përket këtij vendimi kemi të dhëna nëlidhje me datën e rregjistrimit dhe të përfundimit të çështjes. Çështja penale është rregjistruar me nr. 52111-02454-208/1472 me datë 17.12.2015, ka përfunduar me vendimin nr. 11-2016-1603 -432 datë 07.4.2016, i demtuar akuzues M. SH, i akuzuar Y M. Për veprën penale të parashikuar nga neni 90/1 i K.Penal dhe 84 i K.Penal. Subjekti i rivlerësimit {...}, ka gjykuar si gjyqtar i vetëm. Gjykimi ka zgjatur **110 ditë**, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale konform vendimit 261/2 të KLD.

## KONKLUZIONI

Referuar Metodologjise se Pikëzimit për të gjitha çështjet që rezultojne nga burimet e vleresimit, rezulton se standarti minimal kohor në fuqi është respektuar në të gjitha çështjet e analizuara.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër në lidhje me treguesin “Respektimi i standarteve minimale afateve ligjore”, duke pasur parasysh edhe shkaqet që kanë ndikuar në këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet në nivelin “0-10%”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

## 2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin analitik të rivlerësimit nuk ka të dhëna apo konkluzione lidhur me këtë tregues

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:***

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 10 (dhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short dhe 1 (një) vendim të përzgjedhura nga gjyqtarja, dhe një vendimi të administruar për shkak të ankesave për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit.<sup>16</sup>

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 10 (dhjetë) çështjet në kategorinë e çështjeve “Penale krime”, rezulton të jetë *61 ditë ose 2 muaj e 1 ditë*, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 9 muaj për gjykimin e çështjeve penale të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë.
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 3 çështjet në kategorinë e çështjeve “Kundravjatje”, rezulton të jetë *56 ditë ose 1 muaj e 26 ditë*, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 4 muaj për gjykimin e çështjeve penale të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë.
- (iii) Në kategorinë e çështjeve “Civile themeli”, nuk kemi të dhëna në lidhje me mesataren e kohëzgjatjes së gjykimit për Gjyqtaren pasi e vetmja çështje civile themeli vendimi i saj nuk na jep të dhëna për datën e regjistrimit të çështjes (*vendimi nr. 7209 date 23.06.2014.*)

## **KONKLUZIONI**

Referuar analizës matematikore si më sipër, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor. Për këtë arsye aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë. Vlerësoj se ky tregues duhet të pikëzohet maksimalisht me 5 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, duhet të konsiderohet më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, prandaj në lidhje me këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

## **2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;

<sup>16</sup> Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se: “*Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi*” Perjashtojmë dosjen (5) të raportit të vlerësimit të KLGJ për të cilën parashikohet afat nga ligji.



- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “ Gjyqtare {...}, në periudhën objekt i këtij vlerësimi profesional(08.10.2013–08.10.2016), ka punuar vetëm dy vite. Kështu, ajo ka kryer stazhin profesional si kandidate për magjistrate, gjyqtare provizore, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në periudhën tetor 2013–gusht 2014 dhe në periudhën tetor 25.09.2015–10.10.2016, ka punuar si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Ndërkohë, në periudhën gusht 2014–shtator 2015, znj. {...}, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës, ka qëndruar në periudhë pritjeje për të marrë emërimin përfundimtar si gjyqtare. Lidhur me ngarkesën sasiore, subjekti i rivlerësimit {...}, në formularin e vetolerësimit ka deklaruar si vijon:

a) Numri i çështjeve të caktuara tre vitet e fundit të ushtrimit të detyrës **679 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë) çështje.**

b) Numri i çështjeve të përfunduara tre vitet e fundit të ushtrimit të detyrës **584 (pesëqind e tetëdhjetë e katër) çështje.**

c) Numri i çështjeve të mbartura në vitin e fundit të ushtrimit të detyrës **81 (tetëdhjetë e një) çështje.** Të dhënat statistikore të mësipërme, janë shoqëruar me shkresën përkatëse lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë si dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, ku ka ushtruar detyrën gjyqtarja {...}. Sipas të dhënave statistikore të vëna në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. 1394/1 prot., datë 14.02.2020, gjyqtare {...}ka përfunduar së gjykuari me vendim përfundimtar **131 çështje** (civile e penale).

-Për periudhën 08.10.2015–08.10.2016), në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës pas emërimit përfundimtar, sipas të dhënave statistikore të përcjella nga ajo gjykatë për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se gjyqtare {...}ka përfunduar së gjykuari **328 çështje.** Nga ky total, 111 janë penasle themeli(krime+kundravajtje penale); 79 janë kërkesa penale; 118 janë masa sigurimi; 2 çështje janë civile themeli dhe 18 janë kërkesa civile. Në lidhje me respektimin nga ana e gjyqtarës {...}, të standartit sasijor të përcaktuar në Aneksin e Vlerësimit, mund të themi si më poshtë vijon: Në lidhje me periudhën që ajo ka punuar si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë( tetor 2013–gusht 2014), znj. {...}ka qënë në periudhë stazhi, për rrjedhojë, ajo nuk ka marrë një ngarkesë të plotë me çështje sikurse i jepet një gjyqtari me emërim definitiv. Pra gjyqtare {...}, për periudhën si gjyqtare stazhiere, nuk ka patur mundësi objektive të respektojë standartin sasijor të paracaktuar nga Sistemi i Vlerësimit për atë periudhë kohore.Në lidhje me periudhën që gjyqtare {...}ka punuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës(25.09.2015–10.10.2016), rezultoi të ketë punuar në Dhomën Penale, por njëkohësisht rezultoi që të ketë gjykuar edhe një numër relativisht të vogël çështjesh civile. Referuar nenit 3 gërma “a” të Aneksit 1, gjyqtari i dhomës penale duhet të gjykojë jo më pak se 100 çështje penale (krime dhe kundravajtje penale). Rezultoi se gjyqtare {...}në periudhën 25.09.2015–10.10.2016, kur ushtronte detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka përfunduar së gjykuari

111 çështje penale (krime dhe kundravajtje penale), pa llogaritur këtu kërkesat penale dhe masat e sigurimit.

Si rezultat, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe tejkaluar standartin sasior sa i takon çështjeve penale të gjykuara për një vit kohor.

Në lidhje me periudhën kohore gusht 2014-shtator 2015, gjyqtare {...}, ka qënë në periudhë pritjeje për të marrë emërimin përfundimtar si Magjistrate, për rrjedhojë ajo nuk ka gjykuar asnjë çështje gjatë asaj kohe...”

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Gjatë periudhës së vlerësimit rezulton se gjyqtarja {...}, për periudhën tetor 2013-gusht 2014 (11 muaj) ka kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe për periudhën 01.10.2015-08.10.2016 (12 muaj) ka ushtruar detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Në analizë do të merret periudha e plotë e ushtrimit të funksionit të gjyqtares pikërisht viti 2016. Referuar të dhënave statistikore të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ku ka ushtruar detyrën rezulton se:

- Në vitin 2016, i janë caktuar 409 çështje, ka përfunduar 394 çështje.

Duke qënë se nuk është përlogaritur rendimenti sipas të dhënave statistikore nga raporti i vlerësimit të KLGJ, duke u bazuar në të dhënat statistikore të sipercituara për të gjithë periudhën 3 vjeçare 01.01.2014-31.12.2016, e cila në këtë rast nuk konsiderohet periudhë e plotë vlerësimi, pasi Gjyqtarja ka filluar detyrën në datë 15.09.2015, rendimenti duhet të përcaktohet referuar raportit të çështjeve të përfunduara 394 çështje me çështjet e caktuara 409 çështje gjatë periudhës së vlerësimit, në masën 96.3%. Ndërkohë brenda një viti ka gjykuar 111 çështje penale themeli dhe kundravajtje duke tejkaluar standartin sasior me vetëm 11 çështje referuar Aneksit 1 pika 3 germa “a” në të cilin një gjyqtar i shkallës së parë dhomës penale si relator brenda një viti kalendarik duhet të ketë realizuar jo më pak se 100 gjykime çështjes penale ( krime /kundravajtje) pra 11% tej standarti minimal sasior të parashikuar.

Në lidhje me kete tregues, gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime duke parashtruar se “Sipas projekt-raportit të vlerësimit rezulton se në lidhje me këtë kriter jam vlerësuar me 8 pikë nga 10 pikë të mundshme. Në projekt-raportin e vlerësimit është përcaktuar se si vit vlerësimi do të merret vetëm periudha 01.10.2015-08.10.2016 duke qënë se kjo periudhë përbën vit të plotë në krahasim me periudhat e tjera. Në përmbajtje të projekt-raportit citohet se për vitin 2016 janë caktuar 409 çështje dhe janë përfunduar 394 çështje. Sipas tabelave statistikore të dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë rezulton se për periudhën tetor 2013-gusht 2014 janë caktuar në total 132 çështje dhe janë përfunduar 131 çështje, duke pasur në këtë mënyrë një rendiment prej 99.2%. Edhe pse kjo periudhë është një periudhë 11 mujore dhe jo periudhë e plotë e ushtrimit të detyrës, vlerësoj se ajo duhet të men et në konsideratë për efekt vlerësimi për sa kohë është pjesë e periudhës së vlerësimit. Fakti

që periudha është 11 mujore dhe jo 12 mujore mund të jetë element që ndikon në vlerësimin e rendimentit të arritur, por jo element për mos marrjen në konsideratë si periudhë vlerësimi. Konkretisht, sipas të dhënave statistikore të dërguara në rrugë elektronike nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë rezulton se për periudhën tetor 2013-gusht 2014 rënë janë caktuar në total 132 çështje nga të cilat kam gjykuar 131 çështje, duke pasur në këtë mënyrë një rendiment prej 99.2%, çka do të thotë +99%. Fakti që periudha e vlerësimit tetor 2013-gusht 2014 nuk ka qenë një periudhë e plotë jo vetëm që nuk duhet të shërbejë për të inos maii ë në konsideratë rendimentin e ai i itur në këtë periudhë, por përkundrazi duhet të shërbejë për ta vlerësuar pozitivisht këtë periudhë për sa kohë rendimenti +99% është arritur pa u plotësuar ende periudha e plotë njëvjeçare, çka tregon edhe përkushtimin tim në gjykimin e shpejtë të çështjeve. Për sa i përket periudhës tjetër të vlerësimit tetor 2015-tetor 2016, ku rendimenti është vlerësuar 96.3%, në zbatim edhe të vendimit Nr. 264, datë 21.11.2019, ku lidhur me vlerësimin e rendimentit përcaktohet se: “Të gjitha të dhënat statistikore e analizohen sipas situates, me qellim analizimin e pretendimet per ceshtje që nuk janë pergjegjesi e gjyqtarit. Analiza e të dliëna»e statistikoi e bar-ollet në koriipleksitetin e çeshtjeve volunimin e çeshtjeve, rritjen e papritur të volumit të ceshtjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat niund të qojnë në një pikëzim me te larte nga ai i tabelës së mesiperme, deri ne pikezim maksimal, nese gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit viti kalendarik nië sliunië se 50% të stantlardit niinial te ngarkeses se përcaktuar nga Keshilli”. Vlerësoj se duhen të merren në konsideratë tre faktorë objektiv: Së pari, përqindja e ngarkesës që më është caktuar në momentin e pjesëmarrjes time në short në vitin 2015. Sipas verifikimeve të kryera rezulton se për shkak të qenies gjyqtare e re e emëruar në gjykatë në muajin shtator 2015 dhe me qëllim balancimin e ngarkesës së gjyqtarëve të tjerë, nga Kryetari i gjykatës në atë kohë është vendosur ulja e përqindjes së pjesëmarrjes në short të disa gjyqtarëve të tjerë (sipas të dhënave të shortit në data të ndryshme rezulton se disa gjyqtarë kanë marrë pjesë me 75% apo 50% në short), ndërkohë që unë kam marrë pjesë me 100% ngarkesë në short. Vetëm për periudhën 07.10.2015- 31.12.2015, më janë caktuar për gjykim 122 çështje penale, të cilat objektivisht është e pamundur të përfundohen brenda të njëjtit vit kalendarik duke marrë në konsideratë afatet e nevojshme për realizimin e njoftimeve, festat e nëntorit dhe festat e fund-vitit. Pavarësisht angazhimit tim për të përfunduar sa më shumë çështje brenda një kohe të shkurtër (nga tabelat statistikore lidhur me çështjet e gjykuara në vitin 2015 rezulton se edhe në periudhën 28.12.2015-31.12.2015 janë përfunduar gjykime), këto aspekte kanë sjellë si pasojë që për një periudhë shumë të shkurtër të marr një numër të lartë çështjesh dhe rrjedhimisht të filloj vitin 2016 me një numër të lartë çështjesh të mbartura për shkak të pamundësisë objektive për të përfunduar gjykimet brenda vitit kalendarik 2015. Së dyti, efektet që sjell qenia e periudhës së vlerësimit një vit kalendarik jo i plotë. Periudha e vlerësimit për efekt të përlllogaritjes së rendimentit është përcaktuar periudha 01.10.2015- 08.10.2016. Sikurse kain parashtruar edhe inë sipër, gjatë muajve tetor 2015-dhjetor 2015, për shkak edhe të pjesëmarrjes 100% të ngarkesës në short dhe uljes së pëi qindjes së pjesëmarrjes së gjyqtarëve të tjerë, kam marrë një numër të lartë çështjesh të cilat objektivisht ka qenë e pamundur të përfundoheshin brenda vitit 2015, duke pasur në këtë mënyrë një ngarkesë të shtuar për vitin 2016. Nga ana tjetër, vetë viti 2016 rezulton i përlllogaritur deri në

*datën 08.10.2016. duke mos marre në konsideratë në këtë mënyrë të gjitha çështjet që unë kam përfunduar në periudhën 09.10.2016-31.12.2016, ndërkohë që rendimenti si rregull përcaktohet në bazë viti kalendarik (1 janar-31 dhjetor). Sipas tabelës së dërguar nga IT i gjykatës rezulton se për periudhën 10.10.2016-31.12.2016 kanë përfunduar edhe 45 (dyzet e pesë) çështje që si datë regjistrimi kanë pasur datën deri inë 08.10.2016 që është data e fundit e periudhës së vlerësimit. Së treti, arsyet e mosrealizimit 100% të rendimentit. Nga tabelat statistikore të dërguara nga IT i gjykatës rezulton e pasqyruar për çdo çështje të shonuar në periudhën e vlerësimit edhe data e vendimmarrjes. Të gjitha çështjet penale apo civile që nuk kanë mundur të përfundohen brënda periudhës së vlerësimit janë ose çështje penale me gjykim të zakonshëm, ose çështje civile që kanë pasur të nevojshme kryerjne nje sere veprimesh gjatë gjykimit si përsëritje njoftimesh, kryerje ekspertimesh etj. Nëse nga ana juaj vlerësohet e nevojshme mund të jap shpjegime për çdo çështje që nuk ka mundur të përfundojë brenda të njëjtit vit kalendarik me qëllim evidentimin e faktit që nga ana ime janë marrë të gjitha masat për respektimin e afateve të gjykimit dhe pasjen e një rendimenti sa më të lanë, por gjykimi i çështjeve nuk ka mundur të përfundohet për shkaqe objektive. Bazuar në sa më sipër, referuar edhe vendimit Nr.264, datë 21.11.2019 “Për miratimin e “Metodologjia e pikezimit me qëllim pëi caktimin e nivelit të vleresimit të gjyqtarit”, i cili ka përcaktuar edhe udhëzimet lidhur me vlerësimin e rendimentit si kriter dhe mundësinë e pikëzimit maksimal nëse kanë ekzistuar faktorë që kanë ndikuar në përqindjen e rendimentin, kërkoj që rendimenti të vlerësohet me **10 (dhjetë) pikë**. Bashkëlidhur do të gjeni tabelat statistikore që 1 përkasin periudhave 2013-2014 dhe 2015- 2016, si dhe informacionin mbi shortin në data të ndryshme që i përkasin periudhës tetor 2015-dhjetor 2015, nga ku rezulton edhe përqindja përkatëse e përfshirjes në short.*

## **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtares për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 96.3 % dhe referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme pikëzohet me 8 pikë. Por, Këshilli duke marrë parasysh dhe kundërshtimet e paraqitura nga ana e gjyqtares, të diskutuara në mbledhjen plenare, arriti në përfundimin që gjyqtarja {...} të vlerësohet me pikëzim maksimal.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” është “Mbi + 99%”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

## **2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR**

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtarja gjatë

periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në kryesekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short )
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, të hartuar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se: *“Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja {...}, i ka kushtuar rëndësinë e duhur edhe arsyetimit në kohën e duhur vendimeve gjyqësore, duke respektuar në katër raste afatet ligjore. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 4 ditë nga shpallja (shih dosjen 1), për 6 ditë nga shpallja (shih dosjen 2) dhe për 1 ditë nga shpallja (shih dosjet 3, 4 dhe 5) Pra, vetëm në një rast është tejkaluar me 1 ditë, afati ligjor për arsyetimin e vendimit (shih dosjen 2). Në këtë rast shkelja e afatit ligjor nuk vlerësohet si domethënëse, pasi është e papërfillshme...”*

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa **afati i ankimit 10 (dhjetë)** ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Ndërsa referuar Kodit të Procedurës Civile, para ndryshimeve me Ligjin 38/2017, afati i dorëzimit të vendimit të arsyetuar në sekretari ishte parashikuar 10 ditë (neni 308 paragrafi 2), me përjashtim të rastit kur gjykata vlerësonte shtyrjen e shpalljes së arsyetuar të vendimit me 5 ditë. Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10 ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

**Dosja 1.** *Çështja penale nr. (71118-02490)1491/211 regjistri themeltar, datë 18.12.2015 regjistrimi, në ngarkim të të pandehurit: Genciana Shehaj, e akuzuar për kryerjen e veprës*

penale të “Ndërtimit të paligjshëm”, e parashikuar nga neni 199/a/1 i K.Penal, e përfunduar me vendimin nr. 592, datë 23.05.2016. Vendimi është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në datë 27.05.2016, brenda 4 ditëve nga shpallja, duke respektuar afatin 5 ditor të parashikuar nga neni 113 i K.Pr. Penale.

**Dosja 2.** Çështja penale nr. (50397-00807)611 regjistri themeltar, datë 06.05.2016 regjistrimi, në ngarkim të të pandehurit Kleo Libohova, i akuzuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës për kryerjen e veprës penale të: “Drejtim i mjeteve në mënyrë të parregullt”, vepër e parashikuar nga neni 291 i K.Penal. Kjo çështje ka përfunduar me vendimin nr. 634(2622), datë 07.06.2016. Vendimi, është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në datë 13.06.2016, brenda 6 ditëve nga shpallja, duke shkelur me vetëm 1 ditë afatin 5 ditor të parashikuar nga neni 113 i K.Pr. Penale.

**Dosja 3.** Çështja penale nr. (71114-01930)1183 regjistri themeltar, datë 14.10.2015 regjistrimi, në ngarkim të të pandehurit Sandër Shkurta, i akuzuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës për kryerjen e veprës penale të “Dhuna në familje”, e parashikuar nga neni 130/a/1 i K.Penal. Kjo çështje ka përfunduar me vendimin nr. 1144, datë 26.11.2015. Vendimi gjyqësor është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Durrës, në datë 27.11.2015, brenda 1 dite nga shpallja, pra në respektim të afatit 5 ditor të parashikuar nga neni 113 i K.Pr. Penale.

**Dosja nr. 4.** Çështja penale nr. (53110-02089)1269 regjistri themeltar, datë 29.10.2015 regjistrimi, në ngarkim të të pandehurit Leonard Valbona, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Trafikim i mjeteve motorike”, e parashikuar nga neni 141/a/1 i K.Penal, e përfunduar me vendimin nr. 387(1394), datë 24.03.2016. Vendimi gjyqësor, është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në datë 25.03.2016, 1 (një) ditë pas shpalljes, pra në respektim të afatit 5 ditor të parashikuar nga neni 113 i K.Pr.Penale.

**Dosja 5.** Çështja penale nr. (61005-01701)673 regjistrimi, datë 30.09.2016 regjistrimi, që i përket: Kërkesit: Prokuroria e Rrethit Durrës, me objekt: “Konfirmimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, caktuar me vendimin Nr. 2323, datë 17.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ndaj shtetasit Skënder Kraja, i biri i Ymer dhe Rukije, i datëlindjes 25.06.1990, lindur në Sukth dhe banues në Sukth, lagja “Perimore”, shtëpi private, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, e parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal. Kjo çështje u përfundua me vendimin përfundimtar nr. 673(4305), dt. 05.10.2016. Vendimi gjyqësor, është dorëzuar në kryesekretarinë e Gjykatës së Rrethit Tiranë në datën 06.10.2016 – pas 1 dite nga shpallja e vendimit, duke respektuar afatin 5 ditor të përcaktuar nga neni 113 i K.Pr.Penale.

Sipas informacioneve të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, lidhur me 6 (gjashtë) nga dosjet e për zgjedhura me shortin e datës 02.03.2023, rezulton se:

**Dosja 6 (1) -** Çështja penale me nr. regjistri 50140-01938/1188 datë regjistrimi 15.10.2015 me kërkesë Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe të pandehur R. K, akuzuar për kryerjen e figurës së veprës penale të “Marredhenie seksuale ose homoseksuale me të mitur”parashikuar nga nenet 101 i Kodit Penal. Çështja ka përfunduar me vendimin nr. 11-2015-6040 (1187), datë 10.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Vendimi nr. 11-

2015-6040 (1187)datë 10.12.2015, rezulton të jetë dorëzuar i arsyetuar në kryesekretari në datën 15.12.2018, 5 (ditë) ditë pas shpalljes së vendimit.

**Dosja 7 (2)** - Çështja penale me nr. regjistri (50397-02298)1389 datë regjistrimi 24.11.2015 me kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe të pandehur A.Gj, akuzuar për kryerjen e figurës së veprës penale të “Drejtim i automjetit në menyrë të parregullt”parashikuar nga nenet 291 i Kodit Penal. Çështja ka përfunduar me vendimin nr. (11-2015-6188) 1219, datë 16.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Vendimi nr. (11-2015-6188) 1219 datë 16.12.2015, rezulton të jetë dorëzuar i arsyetuar në kryesekretari në datën 21.12.2018, 5 (ditë) ditë pas shpalljes së vendimit.

**Dosja 8 (3)** - Çështja penale me nr. regjistri (58318-02199) 1339 datë regjistrimi 12.11.2015 me kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe të pandehur A.S, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armeve luftarake dhe e municionit” parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armeve luftarake dhe e municionit”parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal, Prodhim dhe mbajtje pa leje e armeve te gjuetise”parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal. Çështja ka përfunduar me vendimin nr. (11-2015-6416) 1300, datë 31.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Vendimi nr.(11-2015-6416)1300 datë 31.12.2015, rezulton të jetë dorëzuar i arsyetuar në kryesekretari në datën 31.12.2015, ne te njejten ditë të shpalljes së vendimit.

**Dosja 9 (4)** - Çështja penale me nr. regjistri (53101-01278 )823 datë regjistrimi 12.07.2016 me kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe të pandehur Xh.P, akuzuar për kryerjen e figurës së veprës penale të “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal. Çështja ka përfunduar me vendimin nr. (11-2016-3489)797, datë 28.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Vendimi nr. (11-2016-3489) 797, datë 28.07.2016, rezulton të jetë dorëzuar i arsyetuar në kryesekretari në datën 28.07.2016, ditën e shpalljes së vendimit.

**Dosja 10 (5)** - Çështja penale me nr. regjistri (53101-01171) 860 datë regjistrimi 27.06.2016 me kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe të pandehur A.Ç akuzuar për kryerjen e figurës së veprës penale të “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal dhe G.Sh, akuzuar për kryerjen e figurës së veprës penale të “Pervetësimi i parave ose mallrave qe rrjedhin nga vepra penale ose veprimatria kriminale” parashikuar nga nenet 287/b i Kodit Penal. Çështja ka përfunduar me vendimin nr. (11-2016-3880) 860 datë 13.09.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Vendimi nr. (11-2216-3880) 860, datë 13.09.2016, rezulton të jetë dorëzuar i arsyetuar në kryesekretari në datën 19.09.2016, 6 (gjashtë) ditë pas shpalljes së vendimit duke përfshirë të shtunë të diele data 17,18.

**Dosja 11 (6)** – Kërkesa penale me nr. regjistri (58102-01204) 791 datë regjistrimi 30.06.2016 me kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me objekt caktimin emases mjeksore nga shtetasit F.H, marre nen hetim per vepren penale të “Kundershtim i punonjesit te policise se rendit publik” parashikuar nga nen i236/1 i Kodit Penal. Çështja ka përfunduar me vendimin nr. (11-2016-3405) 778 datë 21.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Vendimi nr. (11-2016-3405) 778, datë 21.07.2016, rezulton të jetë dorëzuar i arsyetuar në kryesekretari në datën 28.07.2016, 7 (shtatë) ditë pas shpalljes së vendimit.

Në lidhje me vendimin e administruar për shkak të ankesave pranë KPK, sa i përket këtij vendimi kemi të dhëna në lidhje me datën e regjistrimit dhe të përfundimit të çështjes.

Çështja penale është regjistruar me nr. 52111-02454-208/1472 me datë 17.12.2015, ka përfunduar me vendimin nr. 11-2016-1603 -432 datë 07.4.2016, i demtuar akuzues M. SH, i akuzuar Y M. Për veprën penale të parashikuar nga neni 90/1 i K.Penal dhe 84 i K.Penal. Në mungesë të të dhënave mbi datën e dorëzimit të dosjes në sekretari, përlllogaritja e kohës mesatare të arsyetimit të vendimit në këtë këndvështrim rezulton e pamundur dhe për pasojë, ky vendim nuk mund të shërbejë si burim vlerësimi për këtë tregues.

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit për çështjet e kategorisë “Penale” është 4 ditë;

## **KONKLUZIONI**

Sa me sipër duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar rezulton “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” është “Më e shkurtër ose e barabartë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

## **2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE**

### **2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Subjekti i rivlerësimit {...}, ka shfaqur aftësit shumë të mira për të kryer procedurat gjyqësore në pesë dosjet e vëzhguara (më hollësisht shih analizën e dosjeve 1-5). Dosjet e vëzhguara të cilat janë të gjitha dosje penale, janë vënë në lëvizje pa vonesa prej saj, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës gjyqësore (shih dosjet 1-5). Në çdo dosje gjenden fletëthirrjet drejtuar palëve, ku pasqyrohet saktë data dhe ora e



seancës gjyqësore. Gjyqtarja tregon kujdesin e duhuar për tu siguruar që palët morën njoftim rregullisht për seancën gjyqësore dhe në rastet kur njoftimi i të pandehurit ka qënë i pamundur nëpërmjet shërbimit postar, gjyqtarja ka vënë në lëvizje edhe policinë gjyqësore për njoftimin e tij. Të gjitha gjykimet që ju përkasin pesë dosjeve të vëzhguara, kanë përfunduar në respektim të afateve standarte apo brenda afateve ligjore të parashikuara.

Nuk konstatohen mangësi në planifikimin dhe kryerjen e veprimeve të duhura procedurale nga ana e gjyqtarës {...}. Në 5 çështjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 1(një) seancë (shih dosjen 5), me 10 (dhjetë) seanca (shih dosjen 4), me 4(katër) seanca (shih dosjen 3), me 2(dy) seanca (shih dosjen 2) dhe me 11(njëmbëdhjetë) seanca (shih dosjen 1) . Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 28 (njëzet e tetë) seanca gjyqësore, nga të cilat 17shtatëmbëdhjetë) seanca kanë qënë produktive dhe 11 seanca gjyqësore ishin jo-produktive. Seancat e vëzhguara përgjithësisht janë çelur sipas planifikimit, duke respektuar orarin e fillimit të tyre, por evidentohen edhe rastet kur seancat kanë filluar me disa minuta vonesë, ku në çdo rast në procesverbalin gjyqësor shënohet shkaku i arsyes së fillimit të seancës me vonesë. Shkaku ka qënë i arsyeshëm, pasi lidhej me vazhdimin e një gjykimi të mëparashëm i cili ka zgjatur përtej parashikimit. Megjithatë, pozitiv është fakti që në asnjë rast fillimi me vonesë i seancës nuk është bërë shkak për dështimin e seancës, por seancat kanë vijuar normalisht. ...”

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :***

Nga 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim, lidhur me numrin e seancave gjyqësore, 10 prej tyre vlerësohen si çështje me palë kundërshtarë për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës, pasi dosja me nr. 5 i takon kategorisë kërkesa penale në fazën e hetimeve paraprake.

➤ Në çështjet e përzgjedhura me short, administruar në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

- Dosja 1. Çështja penale nr. (71118-02490)1491/211 regjistri themeltar, datë 18.12.2015 regjistrimi, e përfunduar me vendimin nr. 592, datë 23.05.2016 e Gjykates se Rrethit Gjyqësore Durrës, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar me 11(njëmbëdhjetë) seanca gjyqësore, të cilat të 5 (pesë) seanca ishin joproduktive dhe shkak për dështimin e tyre ishte mosparaqitja e palëve, ku në katër raste ka munguar vet prokurori, përfaqësuesi i akuzës.
- Dosja 2. Çështja penale nr. (50397-00807)611 regjistri themeltar, datë 06.05.2016 regjistrimi, e përfunduar me vendimin nr. 634(2622), datë 07.06.2016 rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar me 2 (dy) seanca gjyqësore, të cilat ishin produktive.
- Dosja 3. Çështja penale nr. (71114-01930)1183 regjistri themeltar, datë 14.10.2015 regjistrimi, e përfunduar me vendimin nr. 1144, datë 26.11.2015 rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar me 4 (katër) seanca, të cilat kanë qene produktive, arsyet e shtyrjes se nje seancave kane qene per ti lene kohe mbrojtetit të caktuar kryesisht per tu njohur me aktet e prokurorise, dhe per ti lënë kohë palëve për të paraqitur konkluzionet përfundimtare me shkrim.
- Dosja nr. 4. Çështja penale nr. (53110-02089)1269 regjistri themeltar, datë 29.10.2015 regjistrimi, e përfunduar me vendimin nr. 387(1394), datë 24.03.2016, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë

zhvilluar me 10 (dhjetë) seanca, nga të cilat rezulton se Në dosjen nr. 4, janë evidentuar 6 seanca jo-produktive. Joproductive ishin 3 (tre) tre seancat e para, të cilat dështuan për shkak të pamundësisë së gjykatës për të realizuar njoftimin e rregullt të të pandehurit(seanca e parë dhe e dytë), si dhe seanca e tretë për shkak të mungesës së mbrojtësit të zgjedhur nga i pandehuri. Gjyqtarja ka bërë përpjekje për të mundësuar njoftimin e të pandehurit duke kërkuar edhe ndihmën e Policisë së Shtetit. Për shkak të mungesës së mbrojtësve të të pandehurit, dështuan edhe seanca e shtatë dhe seanca e tetë. Meqënëse çështja ishte në fazën e konkluzioneve, gjyqtarja megjithëse konsideroi të paarsyeshme mungesën e mbrojtjes, vendosi të përsërisë njoftimin e tyre pasi mori më parë edhe mendimin e prokurorit. Një seancë dështoi pasi mungoi vet gjyqtarja e cila mori pjesë në një aktivitet trajnues(seanca e nëntë). Nje seance nuk u zhvilluar per arsye se gjyqtarja ishte në aktivitet trajnues te organizuar nga Ministria e Drejtesise, arsye kjo qe vlerësohet e justifikuar.

➤ Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

- Dosja 6 (1) - Çështja penale me nr. regjistri 50140-01938/1188 datë regjistrimi 15.10.2015 ka përfunduar me vendimin nr. 11-2015-6040 (1187), datë 10.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durres. Janë zhvilluar gjithsej 4 (katër) seanca gjyqësore, dy prej të cilave janë shtyrë për të mosformim te trupit gjykues dhe tjetra për ti dhënë kohë Prokurorit të paraqesë diskutimet përfundimtare.
- Dosja 7 (2) - Çështja penale me nr. regjistri (50397-02298)1389 datë regjistrimi 24.11.2015 , ka përfunduar me vendimin nr. (11-2015-6188) 1219, datë 16.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durres. Eshtë zhvilluar gjithsej 1 (një) seancë gjyqësore.
- Dosja 8 (3) - Çështja penale me nr. regjistri (58318-02199) 1339 datë regjistrimi 12.11.2015 ka përfunduar me vendimin nr. (11-2015-6416) 1300, datë 31.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durres. Janë zhvilluar gjithsej 5 (pesë) seanca gjyqësore, një prej të cilave janë shtyrë për të mosformim te trupit gjykues dhe një seancë për ti dhënë kohë Prokurorit të paraqesë diskutimet përfundimtare.
- Dosja 9 (4) - Çështja penale me nr. regjistri (53101-01278) 823 datë regjistrimi 12.07.2016 ka përfunduar me vendimin nr. (11-2016-3489)797, datë 28.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durres. Eshtë zhvilluar gjithsej 1 (një) seancë gjyqësore.
- Dosja 10 (5) - Çështja penale me nr. regjistri (53101-01171) 860 datë regjistrimi 27.06.2016 ka përfunduar me vendimin nr. (11-2016-3880) 860 datë 13.09.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Janë zhvilluar gjithsej 3 (tri) seanca gjyqësore, një prej të cilave është shtyrë për të garantuar të drejtën e mbrojtjes të pandehurit.
- Dosja 11 (6) – Çështja penale me nr. regjistri (58102-01204) 791 datë regjistrimi 30.06.2016, përfunduar me vendimin nr. (11-2016-3405) 778 datë 21.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Eshte zhvilluar gjithsej 1 (një) seancë gjyqësore.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në 10 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtarë (penale themeli) varion nga 1 deri në 11 seanca gjyqësore. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 4.2<sup>17</sup> seanca gjyqësore në çështje penale themeli.

Nga vëzhgimi i 10 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, rezulton se gjyqtarja ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural penal (neni 333 e vijues dhe 342/2 të K.Pr.Penale). Në çështjet penale data e seancës dhe aktet e njoftimit respektojnë afatet 10 ditore të përcaktuara në nenin 333 të K.Pr.Penale. Gjyqtarja ka

<sup>17</sup> Nga raporti i totalit të seancave me nr. e çështjeve penale (42/10) rezulton 4.2.

mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët në dosje dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Përgjithësisht shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si: njoftimi i mbrojtësit të të pandehurit, lënia kohë palëve për të paraqitur bisedimet përfundimtare. Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale, *si rregull*, janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.Penale, 5 (pesë) prej çështjeve penale burim vleresimi, janë perfunduar me 1-2 ose 3 seanca gjyqësore të zhvilluara në total.

Referuar sa më sipër, për treguesin e “*numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short,<sup>18</sup> rezultojnë se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është mbi 3 seanca, por nga ana tjetër gjyqtarja në çdo rast ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

Në lidhje me pikëzimin e këtij treguesi, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, veçanërisht masave për zhvillimin me efektivitet dhe produktivitet të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short, rezultojnë se gjyqtarja në çdo rast ka marrë të gjitha masat e nevojshme për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet. Prandaj, pavarësisht se numri mesatar i seancave është më i lartë se 3, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë, sepse shkalla e kujdesit të treguar nga Gjyqtarja në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë.

## KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtarja duhet të vlerësohet me 15 pikë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.*

<sup>18</sup>Referuar Metodologjisë së Pikëzimit “Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimit), duke përjashtuar ato pa palë ndërgjyqëse”.

## **2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Seancat e vëzhguara përgjithësisht janë çelur sipas planifikimit, duke respektuar orarin e fillimit të tyre, por evidentohen edhe rastet kur seancat kanë filluar me disa minuta vonesë, ku në çdo rast në procesverbalin gjyqësor shënohet shkaku i arsyes së fillimit të seancës me vonesë. Shkaku ka qënë i arsyeshëm, pasi lidhej me vazhdimin e një gjykimi të mëparashëm i cili ka zgjatur përtej parashikimit. Megjithatë, pozitiv është fakti që në asnjë rast fillimi me vonesë i seancës nuk është bërë shkak për dështimin e seancës, por seancat kanë vijuar normalisht. Gjithashtu në procesverbal, në seancat gjyqësore, shënohet ora e hapjes dhe e mbylljes së seancës. Për tu vlerësuar është fakti, që pjesa dërrmuese e seancave gjyqësore janë regjistruar në audio, në funksion të transparencës dhe solemnitetit së gjykimit. Në ato pak raste ku seancat nuk janë regjistruar në audio, sipas shpjegimeve të dhëna në procesverbalin gjyqësor, kjo ka ndodhur për mungesë të sallave të lira pasi ato ishin të zëna nga gjyqtarë të tjerë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës nuk ka salla të mjaftueshme për të gjithë trupën gjyqësore, fakt që krijon vështirësi për realizimin e të gjitha gjykimeve në salla gjyqi ku mundësohet regjistrimi në audio i seancës .”*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Nga 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 10 (dhjetë) prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve penale themeli me palë kundërshtare, 1 (një) çështje i përket kategorisë së kërkesave penale, konfirmim i masës së sigurimi “Arrest në burg”.

Gjyqtarja në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës gjyqësore menjëherë ose deri në 5 (pesë) ditë pas caktimit të çështjes me short duke iu referuar rregullave dhe gjykimit të çështjeve penale. Vetëm për një prej tyre për dosjen që i përket vendimit me nr. (11-2016-3489) date 28.07.2016 dosja është caktuar 8 (tetë) ditë pas datës së caktimit me short gjyqtarës {...} (*Dosja i është caktuar gjyqtarës me shortin e datës 12.07.2016 dhe vendimi për caktimin e seances është marrë me 20.07.2016*). Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore. Në disa raste seancat gjyqësore nuk janë regjistruar me audio nder to janë vetëm 5 seanca për të cilët gjyqtarja ka relatuar dhe shkaku e mosregjistrimit, ku kryesisht ka qënë mungesa salles për të

rregjistruar ose defekte teknike të sisemit audio në të gjitha rastet dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore. Pjesa me madhe e seancave gjyqësore janë rregjistruar me sistemin audio.

Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në shkallë të parë në çështjet penale (*nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale*). Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkaku në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.*). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosje të vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur me vonesa 1 deri në 1 orë e 15 minuta që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallës së gjykimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca kohore, tejzgjatje e gjykimeve të meparshme si dhe për shkak se gjyqtarja priste që të fillonte seancen deri në momentin që IEVP të bentë shoqerimin e të pandehurit dhe kjo është arsyeja me e shpeshte e fillimit të gjykimeve me vonese, prandaj konstatohet një numër seancash (10 seanca)<sup>19</sup> të filluara me më shumë se 20 minuta deri në 1 orë e 15 minuta vonesë nga ora e planifikuar. Në tërësi pavarësisht fillimit me vonesë të po thuajse pjesës me të madhe të seancave gjyqësore, në raport me seancat e analizuar (23.8% e seancave rezultojnë të filluara me vonesë<sup>20</sup>) nuk rezulton që ato të kenë sjellë pasoja në produktivitetin e gjykimit të çështjes. Shkaku i vonesave në zhvillimin e seancave gjyqësore, sipas relativit të gjyqtarës lidhet me pritjen e zhvillimit të seancës gjyqësore me sistemin audio duke qenë se

---

<sup>19</sup> *Dosja 1*: Seanca e datës 19.01.2016 është çelur me 14 minuta vonesë; *seanca e dates 16.02.2016* është çelur me 43 minuta vonesë; *seanca e dates 01.03.2016* është çelur me 45 minuta vonesë; *seanca e dates 30.03.2016* është çelur me 52 minuta vonesë; *seanca e dates 23.05.2016* është çelur me 14 minuta vonesë

*Dosja 3*: Seanca e datës 03.11.2015 është çelur me 17 minuta vonesë; *seanca e dates 20.11.2015* është çelur me 17 minuta vonesë; *seanca e dates 26.11.2015* është çelur me 10 minuta vonesë;

*Dosja 4*: Seanca e datës 22.10.2015 është çelur me 10 minuta vonesë; *seanca e dates 13.12.2015* është çelur me 28 minuta vonesë; *seanca e dates 24.03.2016* është çelur me 1 orë e 15 minuta vonesë;

*Dosja 5*: Seanca e datës 05.10.2016 është çelur me 10 minuta vonesë;

*Dosja 6*: Seanca e datës 10.12.2015 është çelur me 21 minuta vonesë;

*Dosja 7*: Seanca e datës 16.12.2015 është çelur me 49 minuta vonesë;

*Dosja 8*: - Seanca e datës 27.11.2015 është çelur me 53 minuta vonesë; Seanca e datës 10.12.2015 është çelur me 16 minuta vonesë; Seanca e datës 29.12.2015 është çelur me 49 minuta vonesë; Seanca e datës 31.12.2015 është çelur me 15 minuta vonesë;

*Dosja 9*: Seanca e datës 28.07.2016 është çelur me 20 minuta vonesë;

*Dosja 10*: Seanca e datës 18.07.2016 është çelur me 26 minuta vonesë.

*Dosja 11*: Seanca e datës 21.07.2016 është çelur me 10 minuta vonesë.

<sup>20</sup> Kjo përqindje i referohet seancave të filluara me = ose < se 20 minuta vonesë, nga planifikimi.

sallat e gjykimit kanë qenë të zëna me gjykime të tjera dhe vonesat e shkaktuara nga IEVP Durres për shoqërimin e të pandehurve në gjykim.

## **KONKLUZIONI**

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, vlerësohet bazuar ndër të tjera, edhe në shkallën e aftësisë dhe efikasitetit të treguar nga gjyqtarja në kryerjen e veprimeve për fillimin pa vonesë të seancave gjyqësore. Në 10 seancat e filluara me vonesë, referuar relativitetit të gjyqtarës, duket se kanë ndikuar kushtet e punës e infrastruktura e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durres me një numër të vogël salla gjykimi ku proceset regjistrohen në sistemin audio, si dhe vonesat e shkaktuara nga IEVP për shoqërimin e të pandehurve nën masë sigurimi “Arrest në burg”. Gjithashtu duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezultojnë se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 20 pikë.*

## **2.C. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE**

### **2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “ Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, nuk është konstatuar asnjë mangësi tek gjyqtarja {...}, në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtarja ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në dosjet e vëzhguara gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpadia apo kërkesa penale për gjykim bashkë me fashikullin hetimor, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, fletëthirrjet, provat, vendimi përfundimtar, vendimet e gjykatave më të larta etj.

*Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në të pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, janë inventarizuar aktet proceduriale....”*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, ka disa pasaktesi, pasi dosjet e gjyqësore të perzgjedhura me short janë çështje penale dhe nuk kemi të bëjmë me vendim caktimi të seances pergatitore apo procesverbale të seancave pergatitore sic pasqyrohet në përmbajtje konkluzioni i arritur. Në analizë të dosjeve penale burim vlerësimi aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Kjo renditje fillon me aktin e parë me emërtimin “Informacion mbi çështjen” që nënkupton shortin elektronik, vendimin për caktimin e seances gjyqësore, njoftimet e paleve, procesverbali i seancës gjyqësore sipas datave, konkluzionet përfundimtare dhe vendimin përfundimtar të gjykatës. Vihet re që brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave). Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

#### **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë të aftësisë në lidhje me këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” duhet të vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 5 pikë.

## **2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e perzgjedhura me short)
- Aktet e çështjeve të perzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e perzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Në të pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, janë inventarizuar aktet proceduriale”

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (*njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seancë gjyqësore, shkresat drejtuar institucioneve, si dhe vendimi përfundimtar*) si dhe aktet e paraqitura nga palët (*aktet e përfaqësimit të palëve si prokura, provat e administruara, diskutimet përfundimtare të palëve, etj*). Nuk konstatohet mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

## KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar **me 10 pikë**.

### Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtares”

Niveli i vlerësimit AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	98

## 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

### 3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nën kriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: “ Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 20.07.2010 dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2014. Me dekret nr. 8353, datë 21.10.2013 të Presidentit të Republikës, caktohet përkohësisht për të kryer



*stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.Me dekret nr. 9235, datë 25.09.2015 të Presidentit të Republikës, emërohet gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrojë detyrën. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës {...}(shih Të Dhënat nga Burimet Arkivore të KLGJ-së). Madje për tu vlerësuar është fakti, që gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi profesional (08.10.2013-08.10.2016), në ish-Inspektoratin e KLD-së, nuk rezultoi të ishte regjistruar asnjë ankesë e çfarëdolloji për gjyqtaren {...}. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës {...}...”*

### **3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Referuar Raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr.2642/3 Prot., datë 02.02.2022, nuk rezulton te kemi të dhëna në lidhje me ankesat kundrejt subjektit te vlerësimit. Nga arkiva e KLGJ është sjelle informacion 2642/2 prot datë 17.01.2022 nga permbajtja e se ciles rezulton se: *Sipas të dhënave nga databaza e ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013- 8 tetor 2016”, për gjyqtaren {...}nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e ish KLD-së. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren {...}përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton që ndaj saj të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonje mase disiplinore nga ish-Këshilli”.*

Referuar Vendimit nr.582, datë 02.11.2022 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ka patur denoncime kundrejt subjektit te rivlerësimit, reulton se KPK ka shqyrtuar dhe vlerësuar elemente që mund të ndikonin në vlerësimin e lidhur me etikën e gjyqtarës, të cilat pasi janë analizuar në kuader të vlerësimit profesiojal, janë gjetur te pabazuara.

Për periudhën e vlerësimit tetor 2013-tetor 2016, nuk rezultojnë të dhëna që mund të analizohen dhe vlerësohen në drejtim të cenimit të etikës, pasi ato referohen vetëm si pretendime që zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, të cilat nuk përbëjnë burim më vete vlerësimi.

### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

*Shkalla e etikës në punë të gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e etikës së gjyqtarës në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.*

### **3.B. INTEGRITETI I GJYQTARES**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga të dhënat e rezultuara nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Në adresë të veprimtarisë gjyqësore apo jashtëgjyqësore të znj. {...}, nuk është depozituar asnjë ankesë në institucionet kompetente shtetërore, ku të jenë ngritur dyshime për integritetin e gjyqtarës”.

#### **3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :*

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore që kanë lidhje me nderin dhe dinjitetin në ushtrimin e funksionit. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit .

Në materialet për verifikimin e ankesave rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarës, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se: “Në përfundim, nga vlerësimi tërësor i kriterit pasuror, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht. Nga hetimi administrativ dhe

shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën Vetting është përpjekur të deklarojë saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe se pasaktësitë e konstatuara gjatë hetimit administrativ të Komisionit në lidhje me pasurinë e parë shtëpi banimi u sqaruan bindshëm prej saj. 47.1. Në lidhje me pamundësinë financiare të rezultuar në vitin 2014, në vlerën -264.917 lekë, kjo balancë negative është evidentuar për shkak të investimit për blerjen e një automjeti në vitin 2014 të vëllait të subjektit si person i lidhur me të. Bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, kjo pamundësi financiare për trupin gjykues është e atij niveli që nuk sjell penalizimin e subjektit, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. 47.2. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016 ”<sup>21</sup>

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 582, datë 02.11.2022, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në lidhje me integritetin e gjyqtarës, të cilët pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, janë gjetur të pabazuara duke konkluduar se: “Në përfundim në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka deklaruar saktë dhe në përputhje me kërkesat e ligjit të dhënat e kërkuara në deklaratën e kontrollit të figurës. 52.1. Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, përveçse deklarimit të kryer nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me dënimin e vuajtur nga vëllai i saj në Itali. 21 52.2. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit {...} ({...}) ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016”<sup>22</sup>

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarës.

### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

**Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarës në treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.

### **3.C PAANËSIA E GJYQTARES**

<sup>21</sup> Po aty, faqet 20-21.

<sup>22</sup> Po aty, faqet 21.

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: *“Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara, nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.”*

### **3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja, Ivendimi të administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, duke përfshirë dhe regjistrimet audio të seancave (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar akteve burim vlerësimi, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana e gjyqtares.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër aftësia e gjyqtares në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

### **3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARES**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;

- Të dhënat statistikore.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se *“Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit znj. {...}. Për gjyqtaren {...}, në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short, nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve, duke mos ngritur asnjë pretendim për njëanshmëri të gjyqtares në ato gjykime.”*

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtares, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares në periudhën e vlerësimit.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtares. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares është i pakonsiderueshëm.

## KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares. Prandaj, për këtë tregues vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, duhet të vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, në treguesin *“Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares”* është *“I pakonsiderueshëm”*, duke e pikëzuar me 15 pikë.

***Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”***

Nivelin i vlerësimit

ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

#### 4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarës në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

##### 4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit znj. {...}. Për gjyqtaren {...}, në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short, nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve, duke mos ngritur asnjë pretendim për njëanshmëri të gjyqtarës në ato gjykime. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara, nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.”*

##### 4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjor të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja, 1 vendimi të administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (kryesisht procesverbaleve të seancave, përfshirë këtu regjistrimet e seancave me mjete audio, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore) rezulton se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret, në lidhje me çështjen për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat

cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe e drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë dhe koncize, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

## **4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja, 1 vendimi të administruar për shkak të ankesave );
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale të subjekteve të procedimit. Në njerën prej gjykimeve që i përket vendimit nr.(11-2015-6040)1187 datë 10.12.2015 gjyqtarja kujdeset që të zhvillojë gjykimin me dyer të mbyllura meqënëse mosha e të pandehurit është i mitur, bazuar nën 340/2/a i KPrP.

## **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

*Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “I lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

#### **4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: *“Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e gjyqtares {...}, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nuk janë evidentuar vonesa të dukshme në arsyetimin e vendimeve, gjë që tregon se bashkëpunimi i saj me administratën gjyqësore dhe kolegët në këtë drejtim ka qënë në nivelin e duhur.”*

#### **4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, për rrjedhojë, prezumohet se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhënë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.



## KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

### 4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burim vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkallë të ulët të komunikimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhënë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

## KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

#### **4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARES PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “*Subjekti i rivlerësimit {...}, është magjistrate e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës të cilën e ka përfunduar me rezultate të larta. Pas përfundimit të studimeve në Shkollën e Magjistraturës znj. {...} është emëruar përfundimisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, detyrë të cilën vazhdon ta kryej edhe aktualisht. Si gjyqtare, ajo i nënshtrohet detyrimit programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 26 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës (shih të dhënat tek Trajnimet në 3 Vitet e Fundit). Këto të dhëna tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 45 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë. Në dy seminare të tjera të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës znj. {...}, ka marrë pjesë si Asistente në Programin e Trajnimit Vazhdues. Këto të dhëna tregojnë se gjyqtare {...}, ka shfaqur interes të lartë për të marrë pjesë në aktivitete trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, të cilat i kanë shërbyer për të plotësuar më së miri formimin e saj profesional dhe etik. Në kuadër të angazhimit profesional znj. {...}, ka marrë pjesë edhe në aktivitete jashtë Shkollës së Magjistraturës, të cilat i kanë vlejtur asaj si përvojë e mirë profesionale. Kështu, vlen të theksohet se gjyqtarja ka dhënë kontributin e saj edhe në hartimin e reformës në drejtësi. Mbi bazën e disa kontratave të shërbimit të lidhura midis znj. {...} dhe Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, rezulton se magjistratja {...}, ka marrë pjesë në Grupet e Punës pranë Ekspertëve të Nivelit të Lartë, konkretisht në Grupin për Reformën në Drejtësinë Penale, si ndihmës eksperte pranë z. Arben Rakipi (shih të dhënat në pjesën e parë të këtij raporti). Magjistrate znj. {...}, ka qënë e angazhuar edhe në procesin e mësimdhënies, mbi bazën e lejes së akorduar asaj nga ish-Këshilli i Lartë i drejtësisë, ku ka punuar si pedagoge e jashtme në Albanian University (shih të dhënat e pasqyruara në pjesën e parë të këtij raporti).”*

#### **4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARES NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDIET TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtares.

Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr.2642/3 Prot., datë 02.02.2022, vërtetimit me nr. 920/1 Prot., datë 25.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtares, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se ajo ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrëses si dhe në cilesinë e asistentes në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në dy aktivitete trajnuese<sup>23</sup>.

Konkretisht, referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe vërtetimit me nr. 920/1 Prot., datë 25.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës, Gjyqtarja është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e pjesëmarrëses në 26 aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 45 ditë trajnimi.

Rezulton gjithashtu se gjyqtarja ka marrë pjesë në trajnime jashtë Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, i cili rezulton të jetë aktivitet i formimit profesional. Konkretisht, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në trajnimin e mëposhtëm:

1. *Trajnimi me temë: “Garancia e pavarur bankare”, organizuar nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë së Shqipërisë, trajnim i zhvilluar në datë 16-17 prill 2014. Për këtë trajnim subjekti i rivlerësimit ka sjellë edhe certifikatën përkatëse.*

## **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile, penale, procedurale, ndërkombëtare dhe familjare, gjithsej 26 aktivitete të zhvilluara për 45 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.

*Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Shkollën e Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale, është nga 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.*

## **4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARES PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE**

<sup>23</sup> *Fakti i të qenurit në cilesinë e asistentes Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në dy aktivitete trajnuese gjyqtares nuk mund të merret si burim vlerësimi .*

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtares në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtares {...}, ka qënë e angazhuar edhe në procesin e mësimdhënies, mbi bazën e lejes së akorduar asaj nga ish-Këshilli i Lartë i drejtësisë, ku ka punuar si pedagoge e jashtme në Albanian University<sup>24</sup>, gjithashtu e angazhuar edhe në cilesinë e asistentes në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në dy aktivitete trajnuese por kjo i përket periudhës në të cilin gjyqtarja ka qënë në stazh profesional dhe jo e emëruar gjyqtare.

Për sa më sipër, rezulton që gjyqtarja **gjatë periudhës së vlerësimit** nuk ka të dhëna në lidhje me kriterin “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”. Duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

Gjyqtarja {...}, në lidhje me këtë tregues paraqiti kundërshtimet e saj duke parashtruar ndër të tjera se “Nuk është dakord me vlerësimin pasi efekti i këtij qëndrimi është ndarja e periudhës së vlerësimit tetor 2013-tetor 2016 në dy nën periudha: periudha e stazhit profesional dhe periudha e emërimit përfundimtar duke me cilësuar gjyqtare vetëm pas muajit shtator 2015. Nëse do të ishte kështu, atëherë periudha para muajit shtator 2015 nuk do të duhej të ishte përfshirë në periudhën e vlerësimit për vetë faktin se nuk kam qënë e emëruar gjyqtare, ndërkohë që vlerësimi profesional i referohet gjyqtarit në detyrë. Për sa kohë jam vlerësuar për të gjitha kriteret e tjera duke filluar nga muaji tetor 2013, atëherë në të njëjtën mënyrë duhet të merret në konsideratë edhe angazhimi im në mësimdhënie dhe në programin e formimit vazhdues i cili përfshihet brënda periudhës së vlerësimit. Nuk është e arsyeshme që unë të cilësohem gjyqtare gjatë gjithë periudhës tetor 2013-tetor 2016 për efekt vlerësimi të disa kriterëve, ndërsa për efekt vlerësimi të kriterëve të tjera të cilësohem si gjyqtare vetëm nga muaji shtator 2015. Së dyti, lidhur Lidhur me qëndrimin e mbajtur në projekt-raport se angazhimi si pedagoge nuk mund të merret si burim vlerësimi pasi i përket periudhës së stazhit profesional theksoj se periudha e stazhit profesional ka përfunduar në muajin qershor 2014. Stazhi profesional nuk mund të jetë një periudhë dyvjeçare sikurse rezulton nga raporti (tetor 2013-shtator 2015). Pas përfundimit të stazhit profesional unë kam qënë në pritje të emërimit dhe fakti që emërimi është bërë në muajin shtator 2015 nuk mund të ndikojë negativisht në vlerësim për sa kohë emërimi nuk ka qënë në vullnetin tim. Gjatë gjithë periudhës deri në emërimin tim në vitin 2015 unë kam pasur statusin e magjistratit dhe rrjedhimisht angazhimi im si pedagoge përgjatë gjithë vitit 2014, angazhim

---

<sup>24</sup> Vertetimi nr. 36 Prot. Datë 24.01.2017 i Albanian University periudha e mësimdhënies tetor 2010-shkurt 2011 dhe dhjetor 2012-dhjetor 2014, periudhe në të cilin gjyqtarja ka qënë në stazh profesional .

*i cili ka vazhduar edhe pas përfundiinit të stazhit profesional. duhet të merret në konsideratë në vlerësim. Së treti, lidhur me pjesëmarrjen time në trajnime në projekt-raport citohet se pjesëmarrja ka qenë në cilësinë e asistentes dhe rrjedhimisht nuk shërben si burim vlerësimi. Terminologjia e përdorur vlerësoj se nuk duhet të shërbejë për mosmarrjen në konsideratë për efekt vlerësimi të pjesëmarrjes në trajnime. Roli im në trajnimet në kuadër të programit të formimit vazhdues ka qenë i ai lehtësueses. Për të vërtetuar këtë fakt bashkëlidhur do të gjeni:1) vërtetimin Nr.718/2.Prot., datë 13.10.2023, të Shkollës së Magjistraturës, sipas të cilit vërtetohet se unë kam mai i ë pjesë në cilësinë e lehtësueses në dy trajnime me temë “Falimentimi”, në bashkëpunim nde Assist Impact, të zhvilluara në datat 14 tetor 2013 dhe 23 tetor 2013, data të cilat përfshihen brenda periudhës së vlerësimit; 2) letër reference, datë 19.11.2013, të lëshuar nga Assist Impact dhe USAID, ku përcaktohet shprehimisht se unë jam aktivizuar si lehtësuese e programit të trajnimit Ligjislacioni mbi failimentimin”. Për këto arsye, në referim edhe të vendimit Nr.264, datë 21.11.2019 “Për miratimin e Metodologjise se Pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të Gjyqtarit” për këto arsye, në referim edhe të vendimit Nr. 264, date 21.11.2019 "Për miratimin e "Metodologjia e pikezimit me qëllim percaktimin e nivelit te vleresimit të gjyqtarit", ku lidhur me kete kriter percaktohet se: "Me anë të ketij kriteri, Keshilli konsideron vlerë të shtuar per gjyqtarin gatishmerinë e tij për të kontribuar si gjyqtar udheheqes në praktiken profesionale të kandidatëve për gjyqtarë, dhe/ose si ekspert/lehtesues ne trajnimin fillestar apo vazhdues të Shkolles se Magjistratures, apo në trajnime të organizuara nga institucione të tjera", kërkoj qe kjo pjesemarrje të perfshihet ne vleresim. Bazuar në sa më sipër, kerkoj që lidhur me këte kriter të vleresohem me 5 (pese) pikë” .*

Këshilli, pasi dëgjoi relatorin dhe si shqyrtoi kundërshtimet e gjyqtarës, i qëndron faktit që angazhimi në cilësinë e asistentes në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në dy aktivitete trajnuese të sipërpermenduar, i përkasin periudhës në të cilin gjyqtarja ka qenë në stazh profesional, dhe nuk përfshihen në periudhën e gradimit periudhë në të cilën vlerësohet puna dhe kontributi që jep gjyqtarja gjatë kohës së ushtrimit të funksionit. Në këto kushte Keshilli, vlerësoi se nuk është rasti për të përcaktuar një pikëzim të ndryshëm për këtë tregues vlerësimi, nga ai i propozuar nga relatorja.

## **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që per gjyqtaren {...} për këtë tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

**Disponueshmëria e gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, pikëzohet me 3 pikë.

#### **4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARES NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtares, rezulton që gjyqtarja për periudhën e vlerësimit 2013 -2016, gjyqtarja ka dhënë kontributin e saj edhe në hartimin e reformës në drejtësi. Mbi bazën e disa kontratave të shërbimit të lidhura midis znj. {...} dhe Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, rezulton sesubjekti i vlerësimit {...}, ka marrë pjesë në Grupet e Punës pranë Ekspertëve të Nivelit të Lartë, konkretisht në Grupin për Reformën në Drejtësinë Penale, si ndihmës eksperte pranë z. Arben Rakipi.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja është angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

***Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, treguesin “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.*

#### **4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtares, nuk rezulton që gjyqtarja **gjatë periudhës së vlerësimit** të ketë realizuar publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Nga të dhënat në dosjen personale të gjyqtares konstatohet se është depozituar një botim në revistën “Jeta Juridike”, nr. 2 Qershor 2013<sup>25</sup>.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit vlerësoj se për gjyqtaren ky tregues duhet të pikëzohet me 0 pikë.

Gjyqtarja {...} paraqiti kundërshtime në lidhje me këte tregues duke pretenduar në sa parashtrohet më poshtë:

*“Sipas projekt-raportit të vlerësimit lidhur me këte kriter jam vlerësuar me 0 (zero) pike nga 5 (pesë) pikë për shkak se nuk rezulton angazhimi im në publikimet ligjore dhe akademike. Lidhur me këtë aspekt vlerësoj se duhet të merren në konsideratë dy publikimet: Se pari, pjesëmarrja në cilesinë e redaktueses të publikimit "Manual mbi ligjin shqiptar për falimentimin", botuar nga shtëpia botuese "Maluka", në fund të vitit 2013, vit i cili perfshihet në periudhën e vlerësimit. Lidhur me këtë redaktim vlerësoj të parashtroj se nuk ka qënë një redaktim i thjeshtë gjuhësor, por është verifikuar përmbajtja e gjithë librit dhe është pershtatur me termat juridike të ligjit tonë për falimentimin duke kryer shpesh edhe korrigjimet perkatëse në terma. Në letër referencë, datë 19.11.2013, të lëshuar nga Assist Impact dhe USAID, përcaktohet shprehimisht edhe kontributi i dhënë nga ana ime për hartimin e manualit. Së dyti, dhënia e kontributit në publikimin e materialit "Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore" nga Prof.Dr. Arta Mandri-Balili në muajin prill 2014. Dhënia e këtij kontributi është cilesuar shprehimisht edhe nga autorja në faqen 8 të materialit. Lidhur me publikimet e mesiperme vlerësoj të theksoj se i përkasin periudhës së stazhit profesional tetor 2013-qershor 2014, periudhë e cila perfshihet në periudhën e vlerësimit. Asnjë prej aktiviteteve të mësipërme apo pjesëmarrja si lehtësuese në programin e formimit vazhdues pranë Shkolles së Magjistratures nuk ka ndikuar në vlerësimin tim perfundimtar ku unë jam renditur e para pasi vlerësimi nga Shkolla e Magjistratures është bazuar vetëm në rezultatet e pjesëmarrjes gjatë orëve të mesimit, provimeve perkatëse dhe dosjes gjyqësore të përzgjedhur gjatë stazhit profesional. Jo vetëm që pjesëmarrja si redaktuese e Manualit mbi ligjin shqiptar për falimentimin nuk është marrë në vlerësim nga Shkolla në perfundim të stazhit profesional, por edhe vete provimi i realizuar në shkollë në kuader të lëndës "Falimentimi" u vlerësua të mos perfshihej si lëndë që do të ndikonte në renditjen e kandidatëve për shkak edhe të diferencave të theksuara në pikë që patën kandidatet midis tyre ku unë jam vlerësuar me 100 pikë nga 100 të mundshme. Sipas certifikates së vlerësimit për periudhën tetor 2011-qershor 2014 të lëshuar nga Shkolla e Magjistratures rezulton se numri total i pikëve prej 4304.51 pikë, është rezultat i vlerësimit të lendeve perkatëse perfshirë stazhin para-profesional dhe stazhin profesional. Edhe pse pjesëmarrja në cilesinë e lehtësueses apo pjesëmarrja në realizimin e botimeve është realizuar gjatë periudhës në të cilën unë kam qënë në stazh profesional asnjë prej këtyre*

---

<sup>25</sup> Ky botim nuk mund të merret si burim vlerësimi sepse i përket periudhës në cilin gjyqtarja ka qënë në stazh profesional , pasi gjyqtarja {...} është emëruar si gjyqtare në shtator 2015.

aspekteve nuk ka qene pjese e vleresimit nga Shkolla e Magjistratures pasi stazhi profesional është bazuar ne vleresimin e vendimeve të dhena gjatë stazhit dhe dosjes gjyqësore të perzgjedhur për prezantim. Fakti i vetëm që stazhi profesional ka qene pjese e vleresimit nga Shkolla e Magjistratures nuk do të thotë se ne kuader të stazhit është vlerësuar edhe e gjithë veprimtaria shtesë e kryer nga ana ime që shkonte pertej stazhit profesional. Përkundrazi, ka qene rezultatet e arritura si studente e Shkolles se Magjistratures që më kanë dhënë mundesine të perzgjidhem për të marrë pjese si lehtesuese apo per të dhënë kontributin tim në botime edhe pse kam qene ende ne stazh profesional. Bazuar ne sa më sipër, kërkoj që kriteri lidhur me publikimet ligjore dhe akademike të vlerësohet me 5 (pesë) pikë. Bashkëlidhur do të gjeni letër reference, date 19.11.2013, të leshuar nga Assist Impact dhe USAID si dhe pjesen e materialit "Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore" nga Prof. Dr. Arta Mandro-Balili, ku citohet pjesemarrja ime”

## **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 0 pikë për këtë tregues.

Këshilli, pasi dëgjoji relatoren dhe shqyrtoi kundërshtimet e gjyqtares, vlerësoi se nuk ishte rasti për të përcaktuar një pikëzim të ndryshëm për këtë tregues vlerësimi, nga ai i propozuar nga relatorja. Kontributet e mësipërme gjatë kohës së qenies se subjektit në Shkollën e Magjistratures kandidatë për gjyqtare, nuk përfshihen në periudhën e gradimit ku vlerësohet puna por dhe kontributi që gjyqtari jep gjatë kohës së ushtrimit të funksionit te Shkollës së Magjistraturës.

*Angazhimi i gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësoj se në treguesin “Publikime ligjore akademike” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 0 pikë.*

### **Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”**

Nivelin i vlerësimit	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	93

### **NIVELIN I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIM**

Nivelin i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit



1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
<b>Niveli i përgjithshëm i vlerësimit</b>		
Vlerësimi i përgjithshëm	393	Shkëlqyeshëm

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**



## SHTOJCA 1

### KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...} PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013-2016

1. AFTËSITË PROFESIONALE			Piket total		Niveli i vlerësimit
			100		Shkëlqyeshëm
Treguesit		Burimet	Niveli	Piket	Të dhëna për metodologjinë
<b>A. Njohuritë ligjore</b>	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (<i>dosjet e përzgjedhura me short</i>);</li> </ul>	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (<i>dosjet e përzgjedhura me short</i>);</li> </ul>	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
<b>B. Arsyetimi ligjor</b>	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (<i>dosjet e përzgjedhura me short</i>);</li> </ul>	Shumë e lartë	15	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë

					Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (<i>dosjet e përzgjedhura me short</i>);</li> </ul>	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (<i>21 dosjet e përzgjedhura me short</i>);</li> </ul>	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë

## 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE

**Piket total**

**Niveli i vlerësimit**

**100**

**Shkëlqyeshëm**

Tregues	Burimet	Niveli	Piket	Metodologjia	
<b>A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë</b>	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (<i>dosjet e përzgjedhura me short</i>);</li> </ul>	0-10 %	15	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (<i>dosjet e</i></li> </ul>	0-10 %	5	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 % - 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë

		<i>përzgjedhura me short);</i>			11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (<i>dosjet e përzgjedhura me short);</i></li> </ul>	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	<b>Koha mesatare:</b> Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> </ul>	+99 %	10	<b>Tej standardit :</b> Nën 81 % - 2 pikë Mbi 81-87 % - 4 pikë Mbi 87- 93 % - 6 pikë Mbi 93-99 % - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (<i>dosjet e përzgjedhura me short);</i></li> </ul>	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e	15	<b>Koha mesatare:</b> Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural

			çështjeve		për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
<b>B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore</b>	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (<i>dosjet e përzgjedhura me short</i>);</li> </ul>	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	<b>Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (<i>dosjet e përzgjedhura me short</i>);</li> </ul>	Shumë e lartë	20	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
<b>C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar</b>	a. Rregullshmëria e dokumentacionit	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të</li> </ul>	Shumë e lartë	5	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b>

dosjen gjyqësore	të dosjes	përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit ( <i>dosjet e përzgjedhura me short</i> );			E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit.</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (<i>dosjet e përzgjedhura me short</i>);</li> </ul>	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
<b>3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE</b>				<b>Piket total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>100</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimi</b>	<b>Niveli</b>	<b>Piket</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Etika në punë</b>	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> </ul>	Shumë e lartë	35	<b>Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit:</b> E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
<b>B. Integriteti i gjyqtarit</b>	b. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	c. Dosja e rivlerësimit;	Shumë e lartë	40	<b>Shkalla e integritetit të gjyqtarit :</b> E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
<b>C. Paanësia e gjyqtarit</b>	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të</li> </ul>	Shumë e lartë	10	<b>Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës</b>

		përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit ( <i>dosjet e përzgjedhura me short</i> );			<b>diskriminuese:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	a. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	b. Dosja e rivlerësimit;	I pakonsiderueshëm	15	<b>Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit:</b>  Tejet i lartë – 3 pikë I pakonsiderueshëm – 15 pikë
<b>4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL</b>				<b>Piket total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>93</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimi</b>	<b>Niveli</b>	<b>Piket</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Aftësia e komunikimit</b>	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (<i>dosjet e përzgjedhura me short</i>);</li> </ul>	Shumë e lartë	25	<b>Qartësia dhe transparenca e komunikimit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së</li> </ul>	I lartë	15	<b>Respektimi i konfidencialitetit:</b> I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë



		vlerësimit ( <i>dosjet e përzgjedhura me short</i> );			I lartë – 15 pikë
<b>B. Aftësia për të bashkëpunuar</b>	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.</li> </ul>	Shumë e lartë	15	<b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.</li> </ul>	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
<b>C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera</b>	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> </ul>	15-120 ditë	20	<b>Pjesëmarrja e gjyqtarit:</b> (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dosja e rivlerësimit;</li> </ul>	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	d. Dosja e rivlerësimit;	e	Ka të dhëna	5

	ç. Publikimi ligjore akademike	e. Dosja rivlerësimit;	e	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
<b>IVELI I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT</b>				<b>SHKËLQYESHËM</b>		
<b>IKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT</b>				<b>393</b>		

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**